

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7611 E diel 5 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Europa e lirë"
Shumë imamë dhe teologë nga Kosova kanë kryer studimet në botën islame, kryesisht në vendet arabe, gjë që besohet se ka ndikuar në sjelljen e rrymave të ndryshme... **Vijon në faqen 22**

Nga TAULANT QENAJ
Financimi nga organizata të dyshimta ka prodhuar imamë radikale



Opinion i Ditës
E dhe pse gjatë tri viteve të fundit jo pak gazetarë, analistë dhe ekspertë të ndryshëm politikë kanë paralajmëruar fundin politik të Merkel, gruaja më e fuqishme... **Vijon në faqen 21**

Nga DR. JORGJI KOTE
Kryemodel i sjelljes politike



Ish-komandanti: Baza e Kuçovës do të sjellë turizmin ushtarak

NATO merr vendimin: Investim 50 mln euro, ndërtojmë bazë ajrore në Kuçovë

Kryeministri Rama: Diskutime me SHBA për modernizimin e Forcave Ajrore. Ministra Xhaçka: Nisin brenda vitit

Nga DARINA TANUSHI


NATO ka vendosur që të ndërtojë në Shqipëri bazën e parë ajrore të saj në Ballkanin Perëndimor. Kryeministri Edi Rama, ashtu siç lajmëroi edhe pak ditë më parë në një intervistë televizive e dha dje lajmin për këtë...

Në faqet 2-3

DOKUMENTET QE DUHEN PER TE APLIKUAR MARRJEN E CERTIFIKATES SE PRONESISE

HIPOTEKA, PROCEDURAT E REJA PER TE MARRE TAPI

Si bëhet aplikimi për kërkesë për regjistrim, bashkim dhe ndarje pasurish të paluajtshme. Tarifat për çdo shërbim në Zyrat e Regjistrimit



(Në foto) Foto Ilustruese

ÇFARE THONE AGJENTET

Shqiptarët marrin drejtimitin e trafikut të kokainës në Holandë, sfidojnë "Mocromafian"

Në faqen 8

OPERACIONI NE MEMALIAJ

Sekuestrohen 1.5 tonë kanabis dhe 16 armë zjarri pranë shtratit të lumit Vjosa

Në faqen 9

LETET E HAPUR

Somayah Mohammadi: Im atë dëshiron të më kthejë në një skllave për mullahët e Iranit

Në faqen 12

"MILOSAO"

Cili ishte Pal Gazulli, humanisti e ambasadori i Gjergj Kastriotit në Raguzha dhe Itali

Suplement

RISHIKIMI I KUFIJVE



"Ndarjet Kosovë-Serbi", Berisha del kundër, Hashim Thaçi e akuzon: Furnizove Millosheviçin

Në faqet 4-5

Ekskluzive/ Zbulohet dokumenti i vitit 1982 për realizimin e filmit italo-francez në Shqipëri

Kontrata e "Gjeneralit...", që largoi francezët nga Shqipëria

Kush ishte klauzola për librin e Kadaresë me "FILMS 66"

Nga DASHNOR KALOÇI
Ashtu siç kemi parë edhe në disa kapituj paraardhës, diku nga mesi i vitit 1982, kur shoqëria filmike franceze "FILMS 66", e përfaqësuar nga aktori i njohur Michel Piccoli ishte bërë gati për të ardhur në Shqipëri dhe për të filluar



xhirimet e filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", (sipas skenarit të përshtatur nga romani me të njëjtin titull të shkrimtarit të njohur Ismail Kadare), papritur u ndesh me një sërë problemesh të ngritura nga pala shqiptare, e cila iu propozonte për një...

Në faqet 10-11

BAZA USHTARAKE NË KUÇOVË HISTORIKU

Gjenerali tregon bisedimet me SHBA: Nisën që në kohën e Imamit

Ish-komandanti i Forcës Ajrore: Baza e Kuçovës do sjellë turizmin ushtarak

"Një gjeneral i lartë i SHBA erdhi në 2014 për të parë Kuçovën"

Ish-komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade, Frederik Beltoja sgaroi dje përfitimet që do të ketë Shqipëria pas vendosjes së bazës së NATO-s në Kuçovë. Nga Virxhinia e SHBA-ve, ai tha dje për "factor.al" se ky është një lajm i mirë për Shqipërinë, por përpjekjet kanë qenë që në kohën kur ministrin e drejtonte Arben Imami.

Zoti gjeneral Beltoja, kryeministri Rama ka dhënë sot lajmin për vendimin e NATO-s për të ndërtonur në Shqipëri bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor. Si e komentoni këtë lajm?

Është një lajm shumë i mirë. Puna për të propozuar Kuçovën si bazë të NATO-s ka nisur fill pas anëtarësimit në Aleancë. Madje, në kohën kur Ministrinë e Mbrojtjes e drejtonte z. Arben Imami ka pasur biseda dhe janë hedhur ide. Në korrik të 2014-ës, një gjeneral i lartë amerikan, me 4 vje, F. G., komandanti i Forcës Ajrore amerikane në European Command erdhi për të vizituar posaçërisht Shqipërinë dhe bazën ajrore të Kuçovës. Bashkë me ambasadorin e SHBA të atëherëshëm, z. Arvizu e pritëm në Rinas dhe kemi shkruar në zyrën time dhe tek ministria Mimi Kodheli për të biseduar konkretisht. Më pas kemi shkruar bashkë me specialistët e tij, me helikopterin "Cougar" për të parë Kuçovën nga të gjitha këndet.

Cfarë biseduat në Tiranë apo në Kuçovë? Kishte një plan?

Nuk mund të them bisedat konfidenciale. Por ajo çka mund të them pa shkelur asnjë protokoll është se i kërkoja me një dëshirë të madhe kolegut amerikan që Kuçova të ishte sërish një bazë aktive e NATO-s. Ne bëmë një rikonjicion të aerodromit dhe duhet të dini që baza e Kuçovës është gjysmë e gatshme. Ka hapësirën e domosdoshme minale. Ndonëse ka një mungesë të madhe ose handikap, që shpresoj që qeveria dhe Ministria e Mbrojtjes të merren me hapësirën jashtë ba-



Ish-komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade, Frederik Beltoja

BISEDIMET

"Puna për të propozuar Kuçovën si bazë të NATO-s ka nisur fill pas anëtarësimit në Aleancë. Madje, në kohën kur Ministrinë e Mbrojtjes e drejtonte z. Arben Imami ka pasur biseda dhe janë hedhur ide. Në korrik të 2014-ës, një gjeneral i lartë amerikan, me 4 vje, F. G., komandanti i Forcës Ajrore amerikane në European Command erdhi për të vizituar posaçërisht Shqipërinë dhe bazën ajrore të Kuçovës".



BAZA AJRORE

"Nëse do të blejmë avionë, çfarë do të duhet të bëjnë? A mos duhet të përgatitemi për mjetin (avionin). Burimet njerëzore (pilotin, teknikët ejt.), shtëpinë e avionit, (logjistika dhe hangarë). Nëse puna është serioze, duhet menduar për këtë në terma investimesh. Praktikisht duhet filluar puna që sot".

Baza e Kuçovës, vendi ku pajisjet luftarake do të marrin vlerë muzeale



Repartit Ushtarak 3362, Kuçovë, mbante emrin Reparti "23 Peza". Ai u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik, për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej repartit. Krahas këtyre, u morën masa për përgatitjen e ambienteve për prirjen e efektivit dhe teknikës.

Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhiniero-teknik, regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për kryerjen e detyrave. Reparti Ushtarak Kuçovë që mbante em-

rin Reparti "23 Peza" u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të

cilën do të pajisej repartit. Në korrik të vitit 1957 në këtë aerodrom u ul për herë të parë avioni bombardues JI-28, i cili hyri në armatimin e Avionit tonë Luftarak. Në vitin 2001, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në strukturën organizative të Forcave Ajrore, ky repart kalon në Akademia e

parametra sigurie të larta, që aerodromi të jetë me standarde të NATO-s.

A kemi ju një ide për çfarë mund të shërbejë një bazë ajrore e NATO-s në Shqipëri?

E para dhe më e rëndësishmja për ne është air policing, pra, ruajtja e hapësirës së Republikës së Shqipërisë. Sot ruajtja e hapësirës ajrore bëhet nga NATO dhe i është deleguar sipas përcaktimeve, Italisë apo Greqisë.

Forcave Ajrore, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor, Vlorë. Në gusht të vitit 2016 ministria e Ekonomisë, Milva Ekonomi nënshkroi një marrëveshje për të ndryshuar destinacionin e Bazës Ajrore e Kuçovës. Ajo marrëveshje e nënshkruar me një sipërmarrës parashikonte kthimin e bazës në një qendër multifunktionale, për grumbullimin, seleksionimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin të frutave e perimeve të freskëta. Që nga viti 2006, kjo bazë ajrore është e mbyllur e gjithçka çfarë shihet nga pajisjet luftarake do të marrin vlerë muzeale.

Nëse baza të do të jetë në Kuçovë, do të kursehen shumë para për aleancën. Ulen shpenzimet ruajtjes së hapësirës për NATO-n dhe për ne. Mund të rrijë në gatishmëri për air policing. Mund të jetë për emergjencë, për karburant. Pra, baza mund të jetë multifunktionale. Sot për shembull në Kuçovë mund të ulet avionin cargo C130 avione, por jo të tipit "Galaxy". Duhet të vendosim nëse zhurra do të jetë

në shqip apo zhurra në një gjuhë tjetër.

Por, kjo do të thotë që në një të ardhme ne të ndërtojmë sërish flotën ajrore? Pra, të blejmë avionë?

Dakord, kjo është perspektiva. Nëse do të blejmë avionë, çfarë do të duhet të bëjnë? A mos duhet të përgatitemi për mjetin (avionin). Burimet njerëzore (pilotin, teknikët ejt.), shtëpinë e avionit, (logjistika dhe hangarë). Nëse puna është serioze, duhet menduar për këtë në terma investimesh. Praktikisht duhet filluar puna që sot. Për burimet njerëzore duhet punuar që në klasën e 9. Neve nuk na duhen partizanë të ajrit.

Cilat janë përfitimet e këtij investimi të Aleancës dhe Shqipërisë?

Nga ana praktike përfitimet janë të jashtëzakonshme. Do të ketë rritje të punësimit në zone. Do të lulojnë shërbimet, sepse do të jetë ajo që ne e quajmë turizëm ushtarak. Nga ana politike dhe ushtarake, Shqipëria mund të jetë qendër stërvitsh ushtarake dhe e industrisë ushtarake. Ajo për të cilën kam shpresuar dhe punuar. Për shembull, nëse Maqedonia që në një të ardhme do të hyjë në NATO, Mali i Zi që sapo hyri, por edhe Kosova vendosin të marrin në flotën e tyre helikopterë "Cougar", në Shqipëri mund të bëhet një qendër riparimesh. Kjo ishte për të ilustruar një përfitim.

"Factor.al"



Kryeministri Rama: Diskutime me SHBA për modernizimin e Forcave Ajrore

NATO merr vendimin: Investim 50 mln euro, ndërtojmë bazë ajrore në Kuçovë

"Funksionet e bazës, furnizim ajror e mbështetje logjistike"

Darina Tanushi

NATO ka vendosur që të ndërtojë në Shqipëri bazën e parë ajrore të saj në Ballkanin Perëndimor. Kryeministri Edi Rama, ashtu siç lajmëroi edhe pak ditë më parë në një intervistë televizive e dha dje lajmin për këtë vendim të Këshillit të Atlantikut të Veriut. Kreu i qeverisë shkroi dje paradite se NATO do të investojë mbi 50 milionë euro vetëm për fazën e parë të projektit për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës. Duke e cilësuar një lajm shumë të mirë, Rama shkroi: "Këshilli i Atlantikut të Veriut ka miratuar vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor. Me fondet e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe në partneritet me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, NATO do të investojë mbi 50 milion euro vetëm për fazën e parë të projektit për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës". Sipas kryeministrit,



Kryeministri Edi Rama

ERMONELA FELAJ

Deputetja socialiste e Kuçovës, Felaj u shpreh dje se baza në Kuçovë është një superlajm për këtë qytet. Një superlajm, në fakt më i miri për këtë qytet, sepse hap një perspektivë zhvillimi krejt të re, të pamenduar mbase, punësi po se po, biznesi gjithashtu. E meritonin. 50 milionë euro investim nga NATO dhe vetëm si fillim, për të shndërruar bazën ajrore të Kuçovës në një bazë ushtarake të Aleancës", u shpreh Felaj.

Ina Zhupa: Reforma në drejtësi, një farsë politike

Partia Demokratike ka vijuar akuzat për mënyrën sesi po zbatohet reforma në drejtësi dhe konkretisht procesi i vetingut. Përmes një deklaratë për mediat, zëdhënësjë e PD, Ina Zhupa ka denoncuar konfirmimin në detyrë të gjyqtarës së Apelit në Vlorë, Brikena Ukperaj, duke u ndalur tek "3 pikat e errëta të vendimit të organeve të vetingut". Sipas PD, vetingu po vepron me dy standarde. Duke denoncuar me fakte "pasuritë e pajustificuara të gjyqtarës Ukperaj", zëdhënësjë e demokratëve tha se këto prova "zbrërthejnë skemën e Ramës për kapjen e Drejtësisë". Zhupa tha se reforma në drejtësi është një farsë politike. "Partia Demokratike shpreh edhe njëherë shqetësimin se procesi i vetingut, i diktuar nga Edi Rama, po mban në sistem gjyqtarë e prokurorë të korruptuar, në kundërshtim me pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë", tha ajo.



Taulant Balla: NATO mori një vendim historik për Shqipërinë

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, e cilësoi dje "vendim historik", faktin që NATO do të ketë një bazë të saj në Kuçovë. "NATO merr vendimin historik për Shqipërinë duke e shndërruar bazën e Kuçovës në bazë ajrore mbështetëse të NATO-s për furnizim ajror, mbështetje logjistike, mbështetje e policimin ajror si dhe për trajnim dhe stërvitje të Aleancës së Atlantikut Verior. Duke e vlerësuar Shqipërinë dhe qeverinë e saj si partner të besueshëm Këshilli i Atlantikut të Veriut ka miratuar vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore të NATO-s në Ballkanin Perëndimor", u shpreh dje Balla. "Në njoftimin zyrtar konfirmohet se NATO do të investojë mbi 50 milionë euro vetëm për fazën e parë të projektit për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës, duke hapur një histori të re për zhvillimin ekonomik e social të së gjithë zonës dhe rajonit ku planifikohet ndërtimi i kësaj baze të re ajrore. Ky vendim historik i Këshillit të Atlantikut vjen menjëherë pas Samitit të NATO-s në Bruksel 3 javë më parë, ku Presidenti Trump vlerësoi në mënyrë të veçantë kryeministrin Rama për kuptimin dhe sinkronizimin me politikën amerikane të mbrojtjes. Uroj që edhe opozita të jetë zgjuar dhe ta përhëndesë këtë vendim historik për Shqipërinë", deklaroi Balla.

Ministria e Mbrojtjes: Vlerësim për Forcat e Armatosura

Baza e NATO-s në Kuçovë, Xhaçka: Punimet do të nisin brenda 2018-ës

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e cilësoi dje vlerësim që NATO i bën Shqipërisë, duke pasur një bazë të sajën në Kuçovë. Pak minuta pasi kryeministri Edi Rama dha lajmin se NATO do të ndërtojë në Shqipëri bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor, ministria e Mbrojtjes reagoi duke shkruar në rrjetin social "Facebook". "Në këtë 10-vjetor të anëtarësimit tonë në NATO, nuk mund të kishte vlerësim më të madh për seriozitetin, kontributin dhe përkushtimin që pavarësisht kufizimeve e vështirësive, kanë treguar efektivitet e Forcave tona të Armatosura. Krenari për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", u shpreh dje ministria Xhaçka. Ajo tha ndër të tjera se nuk dinte më shumë detaje për projektin, por siguroi se punimet do të nisin brenda 2018-ës. E pyetur në lidhje me fatin e avionëve MIG që mbahen aktualisht në këtë bazë, ministria siguroi se



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka

saj. Do të thosha që është një dhuratë që na bëhet në 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Është një mbështetje edhe për punën e Forcave të Armatosura", - u shpreh Xhaçka. Ajo tha ndër të tjera se nuk dinte më shumë detaje për projektin, por siguroi se punimet do të nisin brenda 2018-ës. E pyetur në lidhje me fatin e avionëve MIG që mbahen aktualisht në këtë bazë, ministria siguroi se

ato nuk do të preken. "Avionët MIG nuk kanë asnjë lidhje, çdo mjet i FA-ve ka një kohëzgjatje jetese dhe pastaj amortizohet, dalin nga përdorimi. Kjo ka të bëjë me një infrastrukturë mbështetëse, që i vjen të gjithë Aleancës dhe rajonit sa i përket furnizimit ajror, mbështetjes logjistike. Nuk ka asnjë lidhje me avionët, janë muze në këtë pikë", - u shpreh ministria e Mbrojtjes.

amerikan të Mbrojtjes, James Mattis. Në atë kohë, ministria tha se, "sekretari Mattis u shpreh shumë i

predispozuar për t'i konsideruar këto kërkesa". E duket se pak muaj më pas, NATO ka vendosur pozitiv-

isht për këtë kërkesë në fakt të përsëritur prej Shqipërisë, në periudha të ndryshme.

KUFIRI KOSOVË-SERBI REAGIMET

Kreu i LDK, Hoti: Deklaratat e presidentit, lojë e tij politike

"Korrigjimi i kufijve", opozita në Kosovë kërkon dorëheqjen e Thaçit

Deputeti i "Alternativa": Mund të shkojmë në tragjedi

Përfaqësuesit e partive opozitare në Kuvendin e Kosovës kanë paralajmëruar se nëse Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi nuk jep dorëheqje, atëherë Kuvendi do t'i fillojë procedurat për shkarkimin e tij për shkak të rrezikimit të tërësisë territoriale të Kosovës. Presidenti i Kosovës ka ripërsëritur deklaratën e tij se në fazën finale të dialogut do të diskutohet për përcaktimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe se pret mbështetje nga NATO-ja për këtë proces. Gjithashtu, Thaçi ka ritheksuar se Lugina e Preshevës duhet t'i bashkohet Kosovës. Këto deklarata të Thaçit po cilësohen të rrezikshme nga ana e opozitës, që korrigjimin e kufijve me Serbinë e sheh si ndarje të Kosovës, ndërkohë që ka paralajmëruar se nëse Thaçi nuk jep dorëheqje, Kuvendi do t'i fillojë procedurat për shkarkimin e tij për shkak të rrezikimit të tërësisë territoriale të Kosovës, shkruan gazeta "Zëri". Në anën tjetër, njohësit e çështjeve politike thonë se deklaratat e Thaçit janë politike dhe jologjore. Sipas tyre, asnjë ndryshim s'mund ta bëjë presidenti pa miratimin e 2/3-s së deputetëve në Kuvend. Shefi i grupit parlamentar të partisë më të madhe opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës, Avdullah Hoti, tha se nuk është momenti për shkëmbim territoresh dhe sipas tij, "deklaratat e presidentit janë lojë e tij politike". "Unë mendoj që nuk është koha për ide të tilla, Kosova është shpallur shtet i pavarur në vitin 2008 në tërësinë territoriale që e ka gëzuar në vitin 1989 dhe pastaj ajo deklaruar e pavarësisë është shpallur në Parlamentin e Kosovës dhe ka marrë, nëse mund të themi, bekimin e drejtësisë ndërkombëtare përmes opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kanë qenë breza të tërë të shqiptarëve në Kosovë që kanë luftuar, dërdhur gjak, djersë dhe mund për këtë projekt që e kemi tash edhe ta kenë të qartë të gjithë se projekti i



ILIR DEDA

Deputeti Ilir Deda nga partia opozitare "Alternativa" i drejtoi një letër të hapur presidentit duke i tërhequr vërejtjen atij se, "politikatat për ndryshim të kufijve mund të çojnë në tragjedi njerëzore". "Ju bëj thirrje publike që pa ekuivok të tërhiqeni nga aventura të tilla politike dhe të jepni dorëheqje", i tha Deda Thaçit.

Ish-deputetja kosovare: Thaçi me Nanon ndaluan vizitën e Berishës në Kosovë

Ish-deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Melihate Tërmkollli ka thënë se Sali Berisha nuk ishte lejuar të hynte pasluftës në Kosovë, pasi pengesë ishin bërë Hashim Thaçi dhe Fatos Nano. Ajo ka mohuar deklaratat e presidentit aktual se Rugova nuk e kishte lënë Berishën të shkelte në Kosovë. Politikanja e njohur kosovare, njëherësh ish-deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Melihate Tërmkollli, ka reaguar ndaj një deklarate të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili sulmoi ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berishën për deklaratat e këtij të fundit që tha se është kundër shkëmbimit të territorit Kosovë-Serbi. Thaçi, duke iu kundërpërgjigjur Berishës, tha: "Këta që sot kundërshtojnë vullnetin e shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës për




bashkim me Kosovën janë të njëjtit që presidenti Rugova për së gjalli nuk i lejoi ta shkelin tokën e Kosovës. Këshillat e tyre i takojnë kohës së turp të historisë shqiptare". Ndërkaq, Tërmkollli, përmes një reagimi dërguar mediave, me titullin "Gjarpri 'në përgafim' të Rugovës, për të 'therur' Sali Berishën", ka thënë se Presidenti Thaçi ka lëshuar "edhe një gënjeshtrë historike" duke përdorur presidentin historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, për

të sulmuar ish-presidentin e Shqipërisë Sali Berishën, i cili sipas saj, ka reaguar "si çdo shqiptar kundër pretendimeve për ndarje të Kosovës dhe goja bashkim me Preshevën". "Presidenti Thaçi gënjën opinionin e paimformuar (sepse pjesa më e madhe e di të vërtetën), kur thotë se presidenti Rugova nuk paska lejuar që Sali Berisha të shkelte tokën e Kosovës", dmth., nuk paska lejuar që Sali Berisha ta vizitonte Kosovën. Sa për të kthjellur memorien, duhet thënë se ishte pikërisht Hashim Thaçi, bashkë me Fatos Nanon dhe të gjithë kreatorët e 'revolucionit të vonuar demokratik', ata të cilët paralajmëruan trazirën në Kosovë në rast të vizitës së Sali Berishës, gjë e cila e detyroi UNMIK-un të anulonte këtë vizitë", ka theksuar Tërmkollli, raporton "Koha.net".

Kosovës së pavarur edhe ky është kompromis për realizimin e interesave të çështjeve kombëtare", citojnë mediat lokale shefin e deputetëve të LDK-së. Janë edhe deputetë të tjerë që zëshëm e kundërshtojnë Presidentin Thaçi për idetë e tij. Deputeti Ilir Deda, nga partia opozitare "Alternativa", i drejtoi një letër të

hapur presidentit duke i tërhequr vërejtjen atij, se "politikatat për ndryshim të kufijve mund të çojnë në tragjedi njerëzore". "Ju bëj thirrje publike që pa ekuivok të tërhiqeni nga aventura të tilla politike dhe të jepni dorëheqje. Dorëheqja e juaj do ta shpëtonë Kosovën nga shkatërrimi dhe juve do t'ju

mundësonte që të jetoni në Kosovë si një ish-udhëheqës dhe qytetar që i ka pranuar gabimet e veta dhe është penduar për ato", shkroi në letërën e tij Ilir Deda. Por, nga ana e tij, deklarimet e presidentit Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj i cilëson vetëm si një "kundërpërgjigje ndaj Serbisë". "Retorika për



Ekspertja për Ballkanin: Ndryshimi i kufijve apo shkëmbimi i territoreve, përshkallëzim i rrezikshëm

Ndryshimi i kufijve apo shkëmbimi i territoreve mund të jenë një përshkallëzim të rrezikshëm, komenton për "DW" Johanna Deimel, eksperte e Ballkanit pranë Shoqatës së Studimeve për Evropën Juglindore. "Ndryshimet e kufijve kanë gënjeshtrë një vijë e kuqe për BE-në dhe Uashingtonin. Atashimi i Preshevës përmendur nga presidenti Thaçi "me një taktikë retorike" faktikisht do të thotë shkëmbim territorësh me pasojë të paparashikueshme për të gjithë rajonin: për Maqedoninë, që sapo ka marrë ftesën e anëtarësimit në NATO, për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe për serbët, që jetojnë në jug të lumit Ibar në Kosovë. Një destabilizim nuk mund dhe nuk duhet të jetë në interesin e BE-së dhe të vendeve anëtare të tij dhe as në rajon", shprehet ekspertja për Ballkanin. "Tani kur kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet nga pavarësia e Kosovës, rikthimi tek ideja e atashimit të Preshevës dhe heqjes dorë prej veriut të Kosovës mund të shkaktojë një përshkallëzim të rrezikshëm, madje edhe provokues. Nëse vërtetë pas dyerve të mbyllura në Uashington zhvillohen bisedime serioze për një shkëmbim territorësh, atëherë Brukseli do të humbiste kontrollin. Kjo do të kishte si pasojë dështimin e të gjitha përpjekjeve të nismave në frymën evropiane për vendosjen e ekuilibrit dhe afrimin - duke përfshirë këtu edhe vet dialogun e Brukselit mes Beogradit dhe Prishtinës", shkroi Johanna Deimel, eksperte e Ballkanit pranë Shoqatës së Studimeve për Evropën Juglindore.

kufijtë ose për territore të ndodh në Kosovë, mendoj se është kundër-reagim i një retorike që vjen nga Beogradi, goja për të drejtat e Serbisë në Kosovë, më konkretisht për veriun, pra kjo është thjesht një kundër-reagim. Kjo retorikë nuk e ka qëllimin të prishja e rendit dhe të ligjit dhe të sigurisë

në Kosovë dhe duhet të ndihen të sigurt të gjithë në Kosovë për shkak të kësaj retorike, as serbët e Kosovës, as komunitetet e tjera, por as shqiptarët nuk duhet të ndihen të rrezikuar. Është retorikë politike, publike, kundër-retorikë e një retorike që vjen", thotë kryeministri Ramush Haradinaj.



Ndoka, Thaçit: Zgjidh, do statujë prej bronzi apo mermeri

Qëndrimi i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi për ndryshimin e kufijve të Kosovës me Serbinë ka sjellë reagime të ashpra jo vetëm nga kundërshtarët e tij politikë, por edhe nga politikanët shqiptarë. Përmes një statusi në "Facebook", kreu i PDK-së, Nard Ndoka, ka theksuar se i vetmi politikan i dashur për Shqipërinë dhe për Kosovën është ish-kryeministri Sali Berisha, i cili gjatë qeverisjes së tij ka bërë vepra madhore, ku një ndër to është Kruga e Kombit. Ndërkohë, Ndoka i ka bërë thirrje presidentit Thaçi që ka ardhur momenti që ai të zgjedhë se cili do të jetë pozicioni i tij në histori, duke i thënë që të zgjedhë mes një statujë bronzi apo mermeri. "Ka ardhur koha që politikanët kosovarë që kanë marrë pjesë në luftë të largohen nga politika, po e bëjnë pis Kosovën dhe Shqipërinë. Të zgjedhin, statujë prej bronzi apo mermeri, kaq mund të bëjë historia për ta, për me tej po vetëdemaskohen", u shpreh Ndoka.

PD reagon pas akuzave të presidentit kosovar

Tritan Shehu: Berisha, rol të pazëvendësueshëm për Kosovën

Partia Demokratike reagoi dje pas akuzave të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi përmes ish-ministrit të saj, Tritan Shehu. Ai tha se Berisha ka kontribut për demokratizimin e kombit dhe se nuk është e vërtetë që ka punuar kundër interesave të shqiptarëve. "Me shumë habi dëgjova, pikërisht sapo bëra një postim për rolin e Berishës në mbështetje të Kosovës, një sërë 'akuzash' ndaj tij, diametralisht të kundërta me realitetin, rolin e kontributin e tij. Si një njeri që ka bashkëpunuar gjatë me atë, që kam pasur nderin të jem dhe ministër i Jashtëm kur ai ishte president, nuk mund të mos indinjohem thellë nga ato", shkroi dje Shehu. "Nuk ia vien të shkruash gjatë për të rrezuar të tilla shtrembërime, por nuk mund të rri pa theksuar atë që është e vërteta, rolin e pazëvendësueshëm të Berishës, jo vetëm për demokratizimin e hapjen e Shqipërisë, por edhe për kombin tonë, përfshi e Kosovën e rajonin", shkruan në një koment në "Facebook" deputeti demokrat. "Një faktor thelbësor në arrijtje e paimagjinueshme të shqiptarëve në këto 25 vite kanë qenë dhe zhvillimet demokratike në Shqipëri, ecja e saj e shpejtë drejt NATO e BE, racionaliteti e vizioni i politikave tona, roli thellësisht integruar e stabilizues për rajonin që ne luajtëm prej marsit 1992. Dhe pa dyshim roli i Berishës si lideri i lëvizjes e proceseve tona demokratike ishte parësor në të gjitha këto procese. Fatmirësisht edhe aktualisht mendimi e autoriteti i tij i padiskutueshëm vazhdon të jetë një mbështetje e ndihmë e madhe në këtë drejtim, që duhet dëgjuar e vlerësuar me kujdes", u shpreh Tritan Shehu.

Rishikimi i kufirit përplas presidentin kosovar me ish-presidentin e Shqipërisë

"Kufiri Kosovë-Serbi", Berisha kundër, Thaçi e akuzon: Furnizove Millosheviçin

Ish-kryeministri: Jam kundër çdo lloj copëtimi

Cështja e kufirit të Kosovës me Serbinë përplasi dje në distancë Presidentin kosovar, Hashim Thaçi dhe ish-kryeministrin shqiptar, Sali Berisha. Në një deklaratë që bëri dje pas një takimi me delegacionin e Partisë Demokratike Shqiptare të Luginës së Preshevës, të kryesuar nga Ragmi Mustafa, ish-kryeministri Berisha shprehu kundërshtinë e tij për preken e kufijve të Kosovës. Por imënjëherëshëm qe reagimi i Presidentit të Kosovës, Thaçi, një reagim i ashpër. Ai iu drejtua Berishës me fjalët: "Institucioneve të Republikës së Kosovës sot më së paku u duhen këshillat e të dëbuarve me votë masive nga skena politike. Veçanërisht të atyre që në mes viteve 1992-1997 tregtonin dhe bënin që me punët e tyre të pista të mbijetonte makineria ushtarake dhe policore e kasapit të Ballkanit, Sillobodan Millosheviç. Ata duke mbushur xhepat e tyre, u kujdesën me devotshmëri që rezervuarët e tankeve dhe autobusit plot, përkundër faktit se bashkësisia ndërkombëtare kishte vënë sanksione kundër Millosheviçit". "Nuk i duhen këshillat e atyre që strehuan Bin Ladenin, vrasësin e civilizimit botëror si dhe Arkanin, vrasësin e shqiptarëve të Kosovës. Nuk i duhen këshillat e atyre që burgosën komandantin legjendar Adem Jashari, si dhe komandant të shquar si Fehmi e Xhevit Lladrovci, Zahir Pajazit dhe UÇK-në e etiketuan si terroristë. Këta që sot kundërshtojnë vullnetin e shqiptarëve të Preshevës, Bujanovcit e Medvegjes për bashkim me Kosovën, janë të njëjtit që Presidenti Rugova për së gjalli nuk i lejoi ta shkelin tokën e Kosovës. Këshillat e tyre i takojnë kohës së turpër të historisë shqiptare", u shpreh Thaçi.

ISH-KRYEMINISTRI

Ish-kryeministri Berisha u shpreh dje, se "shqiptarët e komunave të Luginës kanë nevojë për garantimin e të drejtave të tyre në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, investime dhe zhvillim e jo që të përdoren për interesa të Serbisë për tregti terriroresh. Është fakt i pamohueshëm se Serbia gjithnjë ka dashur t'u përdori si plaçkë tregu dhe për shkëmbim terriroresh. Personalisht unë kam qenë dhe jam gjithnjë për paprek-



NDIHMJA PËR PRESHEVËN

Ish-kryeministri Berisha tha se qeveritë e Kovës dhe të Shqipërisë e nisën ndihmën për Luginën e Preshevës me një shumë qesharake 100 mijë euro dhe në vend që të trisnin ndjeshëm nga viti në vit këtë shumë, e ndërprejnë fare. "Në shtator, ne do kërkojmë që buxhetit t'i shtohet zëri për Komunitat e Luginës", njoftoi Berisha vendimin e PD-së.

Thaçi, thirrje qytetarëve: Mos u provokoni, shembull korrigjimi i kufirit Belgjikë-Holandë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, vazhdon të këmbëngulë që Kosova dhe Serbia duhet të korrigjohen kufirin ndërmjet tyre dhe kjo çështje sipas presidentit do të ketë mbështetjen ndërkombëtare, nëse përfshihet në marrëveshjen përfundimtare Kosovë-Serbi. Në një konferencë të radhës për mediat, Presidenti Thaçi tha se, "është mundësia historike që Kosova dhe Serbia ta korrigjohen në mënyrë paqësore kufirin" dhe përmendi këtu që në territorin e Kosovës të përfshihen komunat jugore të Serbisë, Presheva, Bujanovci e Medvegja. Por, tha se, "në Kosovë nuk do të ketë ndarje dhe Kosova nuk ka territor për t'i



dhënë Serbisë". "Institucioneve tona nuk guxojnë t'i mbyllin sytë dhe ta injorojnë një mundësi të tillë historike dhe të papërsëritshme. Duhet të bashkohemi dhe t'i themi 'po' kësaj kërkesë krejt racionale, të drejtë dhe historike, e cila ka mundësi të realizohet krejtësisht në mënyrë paqësore", tha Presidenti Thaçi, duke marrë shembull korri-

gjimin e vijës kufitare ndërmjet Holandës dhe Belgjikës dhe për këtë arsye thotë ai, nëse kufiri i Kosovës korrigjohet, nuk është rast precedent. Presidenti i Kosovës fton të gjitha institucionet dhe partitë politike të përfshihen në këtë proces, ndërsa paralajmëroi se në fund të procesit, përmes referendumit, qytetarët mund të vendosin për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. "Si president i vendi u bëjë thirrje të gjithë qytetarëve, institucioneve dhe palëve të përfshira në këtë proces, që të përmbahen nga dolojlovokimi dhe të ruajnë qetësinë në një kohë shumë të rëndësishme për vendin tonë", u shpreh Thaçi.

shmerinë e kufijve të Kosovës dhe çdo lloj copëtimi, ndarje apo tregtie me territorin e saj dhe kundër çdo diskutimi për këto çështje". "Mendoj se të njohësh të drejtën Serbisë, fuqisë së humbur nga lufta, të paraqesë pretendime territoriale ndaj Kosovës është gabim i madh dhe historik, është në një farë mënyre një zhbirje e qëllimit dhe rezultatit të luftës dhe kapitulimit të Serbisë. Por kjo është edhe një zhbërje e Kosovës të çliruar në vitin 1999, të njohur në dokumentet ndërkombëtare dhe nga mbi 115 shtete përfshi këtu 95% të vendeve të lira të botës", u shpreh Berisha. Duke folur për takimin

me delegacionin nga Presheva, Berisha shtoi se theksoi se, "Republika e Kosovës është shpallur dhe njohur si shtet i pavarur me kufijtë e saj aktualë ndërkombëtarë, ndaj Serbia nuk ka asnjë të drejtë dhe nuk duhet t'i njehet asnjë e drejtë për të pretenduar qoftë edhe një pëllëmbë tokë në territor të Kosovës". "Duke theksuar se Kosova nuk i ka asnjë borxh Serbisë dhe se ajo nuk ka asnjë pëllëmbë tokë të territorit të saj, pasi e kundërta është e vërtetë, u shpreha se të pranosh idenë e ndarjes se Kosovës në një mënyrë apo në një tjetër mbështet idenë dhe përpjekjen e Beogradit për Serbinë e Madhe në kurriz të

Kosovës", u shpreh Berisha. "E vërteta është se në këtë rast Serbia kërkon të bëjë tregti, të përdorë si plaçkë tregu terriroret shqiptare, pasi ajo është e shqetësuar nga zgjimi gjithnjë e më i madh i vetëdijes kombëtare tek banorët shqiptarë të Pazarit të Ri. Për të gjitha këto u shpreha se jam kategorikisht kundër dhe se kam bindje se këto përpjekje destabilizuese të Serbisë do të dështojnë. Theksova se çdo marrëveshje dhe çdo zgjidhje duhet të jetë një marrëveshje midis dy vendeve të pavarura që njohin dhe respektojnë integritetin terriroretial të njëri-tjetrit", u shpreh Berisha.

Aplikimi për kërkesë për regjistrim, bashkim dhe ndarje të pasurisë së paluajtshme

Ornela Manjani

Regjistrimi i pasurisë, ndarja ose përpjesëtimi i saj në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme mund të kryhet brenda 15 ditëve me një kosto prej 700 lekësh dhe pa prituri në radhë në dyert e zyrave të hipotekës. Në faqen "e-Albania" çdo person që dëshiron të kryejë veprimet me pronën mund të aplikojë online, të plotësojë dokumentet dhe të presë dokumentin në shtëpi, i cili vjen me anë të postës. Të gjithë procedurat me hipotekën mund të kryhen "online" në "e-Albania". "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të shërbimeve dhe tarifave që aplikohen hipoteka për të gjitha veprimet me pronën. Shërbimet elektronike u vijnë në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një kërkesë për regjistrim e bashkimin, ndarjes apo pjesëtimin të pasurisë së paluajtshme. Nëse pasuritë e paluajtshme në kufij të ngjitur me njëra-tjetrën janë pronë e të njëjtit pronar, si dhe i nënshtrohen në çdo rast të drejtave dhe detyrimeve të njëjta, me kërkesë të pronarit, regjistruesi regjistrojnë bashkimin e tyre, duke mbyllur kartelën që u takojnë këtyre pasurive të paluajtshme dhe duke hapur një kartelë apo disa kartela të reja për pasurinë apo pasuritë e paluajtshme që dalin nga bashkime të tilla, si dhe duke përditësuar hartën kadastrale.

KËRKESA

Me kërkesën me shkrim të pronarit të vetëm, apo të gjithë bashkëpronarëve për ndarjen e një pasurie të paluajtshme në dy a më shumë pjesë të kësaj pasurie, regjistruesi bën regjistrimin e ndarjes, duke mbyllur kartelën për pasurinë e paluajtshme që ndahet, hap kartelë të reja dhe përditëson hartat kadastrale për pasuritë e paluajtshme të reja, që dalin nga ndarja dhe regjistrojnë në kartelë e reja të gjithë informacionin që kishin kartela e mbyllur. Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të. Kur një pronar dëshiron ta ndajë në pjesë pasurinë e paluajtshme të tij, regjistruesi i kërkon atij të dorëzojë një plan rilevimi të nënndarjeve të propozuara, të përgatitura prej një topografi të licencuar. Në të gjitha rastet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni, pronarët dorëzojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme certifikatën origjinale të pasurisë, që do të bashkohet ose do të ndahet, si dhe pajisen me certifikatë të reja pronësie për pasuritë e krijuara.

SHQYRTIMI

Pas dërgimit të aplikimit drejt ZRPP-së, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi

Procedurat e reja në hipoteka, tarifavat për çdo shërbim

Dokumentet, tarifavat dhe afati për certifikatën

PASURI E PALUAJTSHME	
KARTELA, VËRTETIMET DHE CERTIFIKATA	
Lista e shërbimeve	
Lëshim kopje kartelë të pasurisë	Lëshim vërtetim pronësie
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)
Për qytetarët dhe bizneset	Për qytetarët dhe bizneset
Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv)	Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)
Për qytetarët dhe bizneset	Për qytetarët dhe bizneset
Kopje të vërtetuesve të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet Regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme / faqe	Konsultim i kartelës së pasurisë së paluajtshme
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)
Për qytetarët dhe bizneset	Për qytetarët dhe bizneset
Lëshim certifikatë pronësie	Lëshimi i një certifikate të re kur ka humbur apo është dëmtuar certifikatë e marrë
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)
Për qytetarët dhe bizneset	Për qytetarët dhe bizneset

Rregullat e reja për vërtetimin e pronësisë

Ky shërbim elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për pajisjen me vërtetim pasurie për pasuritë që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar. Pas dërgimit të aplikimit drejt ZRPP-së, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike tek "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në "e-Albania", si dhe me shërbim postar, nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të Ligjit Nr. 33/2012 bëhet nga kërkuesi vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noterit apo asistentit i noterit. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike tek "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në "e-Albania", si dhe me shërbim postar, nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të Ligjit Nr. 33/2012 bëhet nga kërkuesi vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noterit apo asistentit i noterit. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pa-

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

- Dokument identifikimi i përdoruesit: kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-Albania") - Dokument pronësie: vërtetim pronësie, harta treguese e pasurisë, planrilevimi, planvendosje.
- Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit, 5 ditë pune
- Periudha e vlefshmërisë, pa afat.
- Kosto, 1500 lekë.

funkcionon regjistri elektronik i përpunimit të kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistër regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik. Kërkuesi, që paraqet një kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga ZRPP-ja, pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe Kodin e Sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen

gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij. Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit të "Dokumentet e mia" në "e-Albania" dhe informimit me e-mail për shkakimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në ZRPP paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.

gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij. Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit të "Dokumentet e mia" në "e-Albania" dhe informimit me e-mail për shkakimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në ZRPP paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.

gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij. Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit të "Dokumentet e mia" në "e-Albania" dhe informimit me e-mail për shkakimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në ZRPP paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

1. Dokument identifikimi i përdoruesit: kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-Albania").
2. Kërkesë e të interesuarit (e skanuar).
3. Planrilevimi.
4. Certifikatë pronësie.
5. Kartela e pasurisë.
6. Kontratë pjesëtimi ose vendim gjykatë.

HAPAT E PROCEDURËS

1. Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal.
2. Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për regjistrim e bashkimin, ndarjes apo pjesëtimin të pasurisë së paluajtshme".
3. Klikoni butonin "Përdor".
4. Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi Zyrën vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, mbi pronën, mbi shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme.
5. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit.
6. Shkaktoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën e nevojshme.
7. Punonjësi i ZRPP-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret, i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit me URL-në e shkakimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në "e-Albania", ose me njoftimin e arsyes së refuzimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit 15 ditë pune.
Kosto 700 lekë.

NDREQJE GABIMESH

Shërbimi elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për korrigjim gabimesh në kartelë. Regjistruesi korrigjon gabimet materiale në certifikatë dhe/ose kartelën e pasurisë së paluajtshme, me kërkesë të pronarit, në rastet e mëposhtme: në rastin e gabimeve ose mungesave që nuk prekin interesat e një pronari tjetër; kur, pas një rilevimi, del se një sipërfaqe e treguar në kartelë nuk është në përputhje me aktin e fitimit të pronësisë. Në këtë rast, regjistruesi njofton më parë të gjithë personat e shënuar në regjistër, të cilët janë të interesuar ose që preken nga ky korrigjim i propozuar; me vërtetimin e ndryshimit të emrit ose adresës së një pronari dhe me kërkesën me shkrim të pronarit, regjistruesi regjistrojnë ndryshimin në kartelë. Kur regjistruesi vëren se në certifikatë ka gabime materiale, lëshon certifikatë të re, pasi janë depozituar certifikatat e mëparshme të pronësisë. Urdhri i regjistruesit për korrigjimin e kartelës, në rastet e parash-

ikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të rishikohet nga kryerregjistruesi. Pas dërgimit të aplikimit drejt ZRPP-së, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me e-mail, dërgimit të përgjigjes elektronike tek "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në "e-Albania", si dhe me shërbim postar, nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të Ligjit Nr. 33/2012 bëhet nga kërkuesi, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noterit apo asistentit i noterit. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme funksionon regjistri elektronik i përpunimit të kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistër regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Dt. 08.08.2018 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Parë për pasurinë:
- Pasuria "Trull+Ndërtëse" me sip.529.25 m2, me adresë Sallmona, Durrës. Me çmim 40 000 Euro
- Pasuria "Arë" me sip.3750 m2, me adresë Hardhishtë, Durrës. Me çmim 22 400 Euro
Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L-11, Biv.kryesor (ish kinma Iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

Rreth 10 mijë subjekte kryesore dhe sekondare me shumë ushtrinë veprimtarinë në kryeqytet për periudhën janar-qershor 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Referuar të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV), gjatë gjysmës së parë të vitit regjistruan 112.410 subjekte kryesore dhe



Të dhënat për periudhën janar-qershor 2018

Në Tiranë operojnë 112 mijë biznese

dytësore, që ushtojnë aktivitetet në Tiranë, nga të cilat 93.241 janë biznese kryesore dhe 19.169 janë biznese dytësore, pra që i disponojnë individë që kanë një sipërmarrje tjetër. Pjesa më e madhe, rreth 47.580 janë biznese të vogla, ndërsa pjesa tjetër janë biznese të mëdha, VIP dhe të

përfshira tek kategori të tjera. Ndërsa po të shikojmë periudhën janar-qershor 2017, janë në total 102.915 subjekte aktive kryesore dhe sekondare, çka do të thotë që gjatë 2018 kryeqytetit i janë shtuar konkretisht 9495 biznese. Pjesa më e madhe e këtyre njësive operojnë në dy

fusha kryesore, "shitje me pakicë" dhe "njësi shërbimi", ndërsa numrin më të vogël e zënë ambulancat me vetëm 131 subjekte. Sa u përket bizneseve të reja të hapura gjatë gjysmës së parë të vitit, regjistruan mbi 4 mijë subjekte ndërsa janë mbyllur dy mijë të tjerë.

"S&P" ruan vlerësimin në B+, apel qeverisë për rreziqet e PPP, përmend edhe deuroizimin

Raporti i "Standard and Poor's", Ahmetaj: Notë pozitive për ekonominë shqiptare

Raporti e vë theksin edhe te mungesa e reformave nga ana e qeverisë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj e ka quajtur pozitiv raportin e "Standard and Poor's" për ekonominë shqiptare. Në një status në "Facebook", Ahmetaj shkruan se raporti vlerëson se performanca fiskale e vendit është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Sipas tij, po ashtu vlerësohet performanca në rritje e të ardhurave buxhetore, miradministrimi si rezultat edhe i uljes së informalitetit, kontrolli dhe ulja e shpenzimeve dhe vazhdimi i reformave strukturore nga ana e qeverisë. "Sërish notë pozitive për ekonominë shqiptare. Agjencia prestigjioze e vlerësimit 'Standard and Poor's' jep një tjetër vlerësim pozitiv për ekonominë shqiptare, duke konfirmuar notën 'B+', me perspektivë të qëndrueshme si ekonomike' ashtu edhe fiskale për periudhën në vijim. Në raportin e publikuar ditën e djeshme, S&P vlerëson se performanca fiskale e vendit është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, mbështetur nga rritja e qëndrueshme ekonomike dhe nga një kuadër fiskal i përmirësuar, i cili tanimë e ka vendosur detyrimin në ligj kontrollin rigoroz të deficitit dhe uljen e tij, duke vendosur nën kontroll risqet e lidhur me të", shkruan ministri në "FB". Sipas tij, ecuria e performancës fiskale të Shqipërisë vlerësohet të mbetet pozitive deri në vitin 2021 dhe më e mirë se vendet me renditje të ngjashme, e mbështetur nga pritshmëritë pozitive të rritjes ekonomike dhe kontrollit të financave publike. "Në të njëjtën kohë, vlerësohet performanca në rritje e të ardhurave buxhetore, miradministrimi si rezultat edhe i uljes së informalitetit, kontrolli dhe ulja e shpenzimeve dhe vazhdimi i reformave strukturore nga ana e qeverisë, kryesisht ajo në sistemin e drejtësisë, të cilat pritet të reflektohen në një renditje më të lartë vitin e ardhshëm", shkruan Ahmetaj.

RAPORTI

"Standard and Poor's" ka mbajtur të pandryshuar në B+ me perspektivë të qëndrueshme notën e borxhit sovran të vendit tonë. Agjencia sqaron në njoftimin e posaçëm që shoqëron këtë vendim se rritja ekonomike



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

përgjatë tri viteve të ardhshme do të jetë mesatarisht në 4% dhe do të nxitet kryesisht nga investimet dhe rritja e eksporteve, kryesisht shërbimeve. Sa i përket vlerësimit të ekonomisë shqiptare, "S&P" nënvizon faktin se vendi vijon me konsolidimin fiskal, por se nga ana tjetër ka ende sfida në këtë drejtim, që kanë të bëjnë edhe me projektet e Partneritetit Publik Privat të qeverisë. Ky paralajmërim vjen vetëm pak ditë pas atij të Departamentit Amerikan të Shtetit. Gjatë tri-katër viteve të ardhshme, rreziqet me të cilat mund të përballohet vendi ynë vlerësohen minimale. Një periudhë më e fortë e stabilitetit ekonomik

e shoqëruar me tërheqjen e më shumë investimeve të huaja si dhe luftën e suksesshme ndaj ekonomisë informale de të gjeneronin një përmirësim të notës së borxhit sovran të vendit - thotë më tej agjencia. Madje, "S&P" për të parën herë nënvizon faktin se, edhe procesi i deuroizimit mund të sjellë një përmirësim të notës, çka përkethehet në kosto më të ulëta huamarrjeje për ekonominë tonë. Nga krahu i kundërt, nota mund të ulet në rast se vihen re deficite fiskale apo edhe materializimi i detyrimeve nga projektet PPP. "S&P" e vë theksin edhe te mungesa e reformave nga ana e qeverisë, pasi fitoi zgjedhjet e vitit të kaluar.

Sigurimi i jetës, rritje modeste për gjashtëmujorin e parë

Tregu i sigurimit të jetës shfaqti rritje modeste të rritjes gjatë gjysmës së parë të këtij viti. Sipas të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, deri në fund të qershorit primet e shkruara bruto të sigurimit të jetës kishin vlerën e 573 milionë lekëve, me një rritje modeste prej 2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Aktiviteti i jetës vazhdon të mbajë një pjesë modeste kundrejt volumit total të tregut të sigurimeve në Shqipëri, me rreth 7.5% të primeve të shkruara bruto. Ecuria e tregut gjatë gjysmës së parë të këtij viti është frenuar ndjeshëm nga rënia në produktin kryesor; atë të sigurimit të jetës së debitorit. Primet nga ky produkt kanë rënë me 7%, krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2017. Si një produkt i detyrueshëm, jeta e debitorit zë rreth 60% të primeve totale në sigurimin e jetës. Në klasat e tjera të sigurimit vëre-

Tabela më poshtë paraqet dëmin mesatar për disa nga produktet e sigurimit motorik.

Type of Insurance	Vlerat (në 000 lekë)		Ndryshimi (në %)
	2017	2018	17/16-1
Dëmi mesatar			
MTPL e brendshme	222	207	(6.62)
Karton Jeshil	1,092	533	(51.18)
Kasko	103	117	13.30

hen ritme të kënaqshme të rritjes, ku produktet me rritjen më të lartë ishin jeta e kombinuar dhe jeta në grup. Megjithatë, tregu i sigurimit të jetës në Shqipëri ngelet shumë i vogël, ndërsa produktet e mirëfillta vullnetare janë pothuajse të papërfillshme për nga pesha e tyre. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-qershor 2018 kapën vlerën mbi 7,707 milionë lekë ose 3.93% më

shumë se në periudhën janar-qershor 2017. Gjatë periudhës janar-qershor 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 570,783 me një rritje prej 8.33% krahasuar me periudhën janar-qershor 2017. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e "Jo-Jetës", të cilat sollën 92.50% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e "Jetës" me 7.43% dhe veprim-

tarinë e risigurimit me 0.07%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar: primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.82% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.18% të totalit të tregut. Gjatë periudhës janar-qershor 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve arritën në rreth 2.287 milionë lekë, ose 15.47% më pak se në peri-

udhën janar-qershor 2017. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-qershor 2018 arritën rreth 4,638 milionë lekë, ose 7.31% më shumë se në periudhën janar-qershor 2017. Produkti MTPL e brendshme, në periudhën janar-qershor 2018 pati një rritje prej 9.41% të vëllimit të primeve të shkruara bruto. Kjo u shoqërua edhe me një rritje të numrit të kontratave prej 6.76% krahasuar me periudhën janar-qershor 2017. Produkti 'Karton Jeshil' në periudhën janar-qershor 2018 pati një ulje prej 1.03% të vëllimit të primeve të shkruara bruto. Kjo u shoqërua nga një rritje e numrit të kontratave prej 12.70% krahasuar me periudhën janar-qershor 2017. Produkti 'Sigurim Kufitar', në periudhën janar-qershor 2018 pati një ulje 3.19% të vëllimit të primeve të shkruara bruto krahasuar me periudhën janar-qershor 2017. Ndërsa numri i kontratave u rrit me 21.51%.

TRAFIKU I DROGES OPERACIONET

Agjentët: Kriminelët mashtrojnë me pasaporta false, ndryshojnë emrat

Shqiptarët marrin drejtimin e trafikut të kokainës në Holandë

Sfidojnë "Mocromaffian", policia frikë nga përplasja

HOLANDË

Kriminelët shqiptarë po zhvendosin "Mocromaffia"-n në tregun holandez të drogës. Është ky paralajmërimi që vjen nga hetuesit e policisë. "Shqiptarët, ashtu si në Angli, kanë marrë përsipër tregun e kokainës". Kështu e nis shkrimin media holandeze "ad.nl", duke iu referuar burimeve policore, e cila u ka kushtuar një shkrim lëvizjeve në tregun vendës të drogës dhe fuqisë së shqiptarëve. Disa kartelet të drogës në jug refuzojnë të bëjnë biznes me "Mocromaffia", emri me të cilin njihen grupet kriminale holandeze dhe marokene, i cili është nën shënjestrën e policisë për shkak të likuidimeve të kohëve të fundit. Kartelet e drogës në Amerikën e Jugut shohin një partner më të mirë tregtar, ata janë shqiptarët. Policia ka frikë nga një përplasje. Ata janë të përfshirë në tregtinë nga disa kilogramë, deri në qindra kilogramë nëpërmjet portit të Roterdamit. Disa nga kartelet e Amerikës së Jugut janë duke refuzuar të bëjnë biznes me holandezët, "Mocromaffia". "Nga ana tjetër, grupet kriminale nga Maroku aktualisht po luftojnë për të bërë transporte të mëdha", thotë një burim i brendshëm. "Shqiptarët janë partner të besueshëm të biznesit. Ata marrin përsipër çdo gjë".

PËRPLASJA

Për shkak të këtij ndryshimi të fuqisë, detektivët kanë frikë nga sulmet e dhunshme midis shqiptarëve dhe "Mocromaffia"-s. "Kemi frikë nga një përplasje. Deri tani, shqiptarët po shmangin përdorimin e dhunës sa më shumë të jetë e mundur jashtë atdheut të tyre, por ne gjithashtu e dimë se ata nuk do të kenë frikë nëse do u duhet të përdorin dhunën".



DETEKTIVËT

Për shkak të këtij ndryshimi të fuqisë, detektivët kanë frikë nga sulmet e dhunshme midis shqiptarëve dhe "Mocromaffia"-s. "Kemi frikë nga një përplasje. Deri tani, shqiptarët po shmangin përdorimin e dhunës sa më shumë të jetë e mundur jashtë atdheut të tyre, por ne gjithashtu e dimë se ata nuk do të kenë frikë nëse do u duhet të përdorin dhunën".

htë atdheut të tyre, por ne gjithashtu e dimë se ata nuk do të kenë frikë nëse do u duhet të përdorin dhunën". Ndërkohë, policia ka hasur vështirësi të mëdha në hetimin e shqiptarëve. Kriminelët mashtrojnë me pasaporta false, ndryshojnë emrat ose qëndrojnë shkurtimisht në Holandë. "Ata qëndrojnë në Gjermani,

MASHTRIMI

Policia ka hasur vështirësi të mëdha në hetimin e shqiptarëve. Kriminelët mashtrojnë me pasaporta false, ndryshojnë emrat ose qëndrojnë shkurtimisht në Holandë. "Ata qëndrojnë në Gjermani, bëjnë biznes në Belgjikë dhe marrin drogë nëpërmjet Roterdamit", thotë një agjent. "Kur sigurojmë foto të tyre, ata tashmë janë zhdukur".

bëjnë biznes në Belgjikë dhe marrin drogë nëpërmjet Roterdamit", thotë një agjent. "Kur sigurojmë foto të tyre, ata tashmë janë zhdukur. Ata e dinë saktësisht se si punon policia dhe përdorin dobësitë tona".

Më pak se 800 shqiptarë janë regjistruar zyrtarisht në Holandë, por policia e di se numri është të paktën

KARTELET E DROGËS

Disa kartelet të drogës në jug refuzojnë të bëjnë biznes me "Mocromaffia"-n, emri me të cilin njihen grupet kriminale holandeze dhe marokene, i cili është nën shënjestrën e policisë për shkak të likuidimeve të kohëve të fundit. Kartelet e drogës në Amerikën e Jugut shohin një partner më të mirë tregtar, ata janë shqiptarët. Policia ka frikë nga një përplasje.

SHQIPËRIA

Më pak se 800 shqiptarë janë regjistruar zyrtarisht në Holandë, por policia e di se numri i tyre është disa herë më i lartë. Ata rrinë në apartamente luksoze në Roterdam dhe Amsterdam. Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Evropën Lindore dhe është pranë futjes në BE. "Shqipëria po punon shumë për të frenuar korrupsionin, por duhet të ndihmohet".

gjashtëfish më i madh. Ata fshihen në apartamente luksoze në Roterdam dhe Amsterdam, ku policia ka gjetur kokainë, armë, makina për numërimin e parave dhe shuma të mëdha parash. Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Evropën Lindore dhe në pritje për hyrje në Europë, shkruan media holandeze.



SHKURTE

Vodhi 2 kg flori në një argjendari, arrestohet pas 4 muajsh i riu nga Tirana

DURRËS - Katër muaj pas grabitjes së një argjendari në bulevardin e qytetit të Durrësit, policia ka mundur të arrestojë autorin. Ai është 22-vjeçari Robert Hasmuca, banues në Tiranë. Ndalimi i tij u bë pas një pune hetimore të specializuar dhe bazuar në prova shkencore, në kuadër të operacionit të koduar "Argjendaria". Më 18 prill të këtij viti, 22-vjeçari Hasmuca, në bashkëpunim me një shtetas tjetër (vijon puna për identifikimin e tij), në lagjen nr.4 të qytetit bregdetar kanë vjedhur me dhunë një argjendari, ku kanë marrë rreth 2 kg flori me vlerë rreth 5.6 milionë lekë. "Uniformat blu kanë ekzekutuar masën e sigurisë "Arrest me burg" të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, vendim nr.216, datë 20.06.2018 në ngarkim të shtetasit Hasmuca, i cili në bashkëpunim me një shtetas tjetër (vijon puna për identifikimin e plotë të tij), në lagjen nr.4 kanë vjedhur me dhunë një argjendari ku kanë marrë rreth 2 kg flori me vlerë rreth 5.6 milionë lekë", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprën penale "Vjedhja me dhunë" në bashkëpunim.

Ktheheshin nga Greqia për ditën e dasmës, çifti i të rinjve aksidentohet në Fier

FIER - Një aksident i rëndë ka ndodhur dje në autostradën Levan-Tepelenë, ku kanë mbetur të plagosur një çift të rinjve. Sipas informacioneve të para, aksidenti ka ndodhur pranë fshatit Selishtë, ku një automjet tip "Skoda" me targa greke ka dalë nga rruga dhe ka përfunduar në një arë. Drejtuesi i mjetit, 31-vjeçari S. Muçaj ka humbur kontrollin duke dalë nga rruga dhe ka përfunduar në një fushë anës autostradës. Mësohet se në makinë ndodhej një çift të rinjsh që po ktheheshin nga Greqia në drejtim të Tiranës, pasi sot do të kurorëzonin dashurinë e tyre në martesë. Të dy janë transportuar në spitalin e Fierit ku sipas bluzave të bardha, gjendja shëndetësore e 31-vjeçarit paraqitet e rëndë si pasojë e disa frakturave të marra në disa pjesë të trupit, ndërsa e fejuara e tij ka marrë plagë të lehta. Shkaku i aksidentit dyshohet se ka qenë lodhja dhe përgjumja e drejtuesit të mjetit. Policia ka shkruar në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të shkakut të aksidentit.

STRATI Shoqëria përbërëse "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shtypjen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Njësi" me sipërfaqe 62 m², me vendndodhje Lagja "Kongresi Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5127+4-2, Zona Kadastrale 8521, Volumi 34, Faqe 193, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kot., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 11,577,384 Lekë.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datën 08.08.2018.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbërëse "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasuritë e dorëzuesin K S të ndodhura në Fashinore Matikëster. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:

- Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq.31, me sipërfaqe 2500 m² ZK 2869 me cmin 1.500.000 lekë
- Pasuria "Are" nr. 206/7 me vol. 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m² ZK 2869, me cmin prej 100.000 lekë
- Pasuria nr. 70/15, vol. 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m² e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me cmin në masën 520.832 lekë

Ankand është progresiv e do të zhvillohet dt 16.08.2018 në orën 15:00 në "Bullv "G.Fishta" Kulla 1, Kati 2, zyra 5. Kont tel: 672082543, e-maili: tllir_vershaj@yahoo.com, WEB: www.powerjustice.al.com.

NJOFTIM

Ne date 08.08.2018 ne oren 16.00 ne zyren e perbaruesit gjyqesor privat Irista Tereziu PF me adresen ne "Rruga Fadli Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Apartament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5. Ure Vaigjurore Berat.Cmimi ne ankand te trefte eshte ne vleren 1,411,200 (nje milion e katerqind e njembdhjete mije e dyqind) lekë.



Polisor "Vjosa", Cannabis Sativa.

MEMALIAJ

Një sasi prej afro 1.5 tonë kanabis sativa si dhe një arsenal armësh është sekuestruar nga policia e Memaliajt. Droga dhe armët u zbuluan në dy furgonë tip "Mercedes Benz", të cilët ishin fshehur në afërsi të fshatit Leshnje në një zonë mes shkurrësh e pemësh, pranë shtratit të lumit Vjosa. Mësohet se dy automjetet me targa të falsifikuara ishin të mbyllur me çelës. Pikërisht brenda dy furgonëve të bardhë, blutë gjetën plot 16 armë zjarri (mes të cilave dhe një snajper) si dhe 1 ton e 463 kg kanabis, e cila ishte e prodhuar më herët dhe një pjesë ishte ngurtësuar drejt dekompozimit. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës dje bënë me dije se sasia e madhe e lëndës narkotike dhe armët u sekuestruan gjatë operacionit të koduar "Vjosa". Ndërkohë, vijojnë intensivisht hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të poseduesve të kanabisit dhe të arsenalit të armëve.

OPERACIONI

Në vijim të punës për kontrollin e territorit, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e kultivimit, trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe të trafikimit të armëve të zjarrit, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative, shërbimet e Policisë të Stacionit të Policisë Memaliaj në bashkëpunim me specialistët e seksionit për narkotikët pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë kanë organizuar dhe zhvilluar operacionin e koduar "Vjosa". Sipas uniformave blu, në afërsi të fshatit Leshnje, Bashkia Memaliaj, në një zonë mes shkurrësh e pemësh, në afërsi të shtratit të lumit Vjosa janë konstatuar të fshehur dhe të mbyllur me çelësa dy furgona të bardhë të markës "Mercedes Benz" me targa të falsifikuara. Gjatë kontrollit grupi hetimor konstatoi se në brendësi të furgonave kishte pako me lëndë narkotike dhe armë zjarri dhe konkretisht: 16 armë zjarri (1 snajper, 12 kallashnikovë, 2 pushkë dhe 1 armë gjahu) si dhe 1 ton e 463 kg lëndë narkotike kanabis sativa

Policia: Trafikantët e fshehën drogën në pyll për të shmangur kontrollin

Sekuestrohen 1.5 tonë kanabis dhe 16 armë zjarri pranë shtratit të lumit Vjosa

Operacioni në Memaliaj, lëndë narkotike u gjet në dy furgonë me targa të falsifikuara



Memaliaj - Operacioni polisor "Vjosa". Sekuestronet një arsenal armësh si dhe një sasi e madhe Cannabis Sativa.

mbajnë armë e lëndë narkotike me qëllim trafikimin e saj, personat që dispononin lëndën narkotike dhe armët e zjarrit i kanë fshehur në pyll, me qëllim shmangies së kontrollit. Operacioni ndiqet me metoda speciale dhe për këtë arsye nuk mund të jepen të dhëna të tjera", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për hetim të mëtejshëm, për veprat penale: "Prodhim dhe shitje të narkotikeve", "Prodhimi dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit" si dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve sportive dhe të gjuetisë".

(prodhuar më herët, një pjesë e ngurtësuar drejt dekompozimit). "Si rezultat i presionit të kontrollit të

ushtuar javët e fundit në atë territor nga shërbimet e policisë për evidentimin e personave që mund të

KONTROLLET

"Si rezultat i presionit të kontrollit të ushtuar javët e fundit në atë territor nga shërbimet e Policisë për evidentimin e personave që mund të mbajnë armë e lëndë narkotike me qëllim trafikimin e saj, personat që dispononin lëndën narkotike dhe armët e zjarrit i kanë fshehur në pyll me qëllim shmangien e kontrollit", thanë burimet policore.

ARMËT DHE DROGA E SEKUESTRUAR

- 12 kallashnikovë
- 2 pushkë
- 1 snajper
- 1 armë gjahu
- 1 ton e 463 kg kanabis sativa

Kapen në flagrancë me 67 kg hashash, arrestohen 4 persona dhe 1 në kërkim

TIRANË - Goditet një tjetër rast i shitjes së lëndëve narkotike në kryeqytet. Në kuadër të operacionit të koduar "Zallmneri" u sekuestrua një sasi prej 67 kg kanabis sativa, ndërsa përfunduan në pranga katër persona si dhe u shpall në kërkim një tjetër. Sipas burimeve policore të arrestuarit janë: Xhevahir Lusha, 47 vjeç; Ilirjan Selimi, 34 vjeç dhe dy vëllezërit Ervin Lika, 30 vjeç e Besnik Lika, 26 vjeç, të gjithë banues në Tiranë. Sakaq, është shpallur në kërkim shtetasi B. H., 26 vjeç, banues në Tiranë. Mësohet se këta persona u kapën në flagrancë nga shërbimet e Policisë në rrugën "Teuta", ku në bashkëpunim me njëri-tjetrin po transportonin qese me kanabis sativa, nga banesa e vëllezërve Lika në bagazhin e një automjeti tip "Golf". Blutë sekuestruan sasinë e drogës, automjetin tip "Golf" dhe 3 aparate celularë. Materialet në ngarkim të personave të mësipërm iu referuan penale "Prodhim dhe shitje lëndësh narkotike e kryer në bashkëpunim".



Tiranë - Finalizohet operacioni antidrogë "Zallmneri". Arrestohen 4 shtetas shpallët në kërkim 1 tjetër. Sekuestronet lëndë narkotike

PERSONAT E ARRESTUAR NË TIRANË

1. Xhevahir Lusha, 47 vjeç, banues në Tiranë.
2. Ilirjan Selimi, 34 vjeç, banues në Tiranë.
3. Ervin Lika, 30 vjeç, banues në Tiranë.
4. Besnik Lika, 26 vjeç, banues në Tiranë.

NË KËRKIM

1. B. H., 26 vjeç, banues në Tiranë.

ave të mësipërm iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën

penale "Prodhim dhe shitje lëndësh narkotike e kryer në bashkëpunim".



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

PROCEDURE PROKURIMI

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Procedurë e veçantë sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 26.11.2014, i ndryshuar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 17.500.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përsëritje: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **06 Shtator 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

DOSSIER KONTRATA FILMIKE

Së shpejti, libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist" i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Ekskluzive/ Zbulohet dokumenti i vitit 1982 për realizimin e filmit italo-francez në Shqipëri

Nga Dashnor Kaloçi


Ashu siç kemi parë edhe në disa kapituj paraardhës, diku nga mesi i vitit 1982, kur shoqëria filmike franceze "FLMS 66", e përfaqësuar nga aktori i njohur Michel Piccoli ishte bërë gati për të ardhur në Shqipëri dhe për të filluar xhirimet e filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", (sipas skenarit të përshatur nga romani me të njëjtin titull të shkrimtarit të njohur Ismail Kadare), papritur u ndesh me një sërë problemesh të ngritura nga pala shqiptare, e cila iu propozonte për një shtyrje të fillimit të xhirimeve. Gjë e cila për ta, as më shumë dhe as më pak do të thoshte se realizimi i filmit nga ana e tyre ishte në kufijtë e së pamundurës. Propozimi për shtyrjen e filmit iu bë palës franceze në datat 23 dhe 24 gusht 1982 nga vetë titullarja më e lartë e Ministrisë së Arsimit e asaj kohe, Tefta Cami, gjë e cila vinte pas një sërë letërkëmbimesh të bëra më parë me ta dhe që ishin nënshkruar nga funksionarët më të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, si Reis Malile, Sokrat Plaka, Misto Treska, Javer Malo, Jorgo Melica, Dilaver Pinderi etj, e deri nga drejtori i Kinostudios "Shqipëria e Re", Vangjush Zallëmi e vartës të tij si Gjergji Pano dhe Niko Mitrushi. Kjo gjë vinte pas një sërë zvarritjesh dhe pengesash subjektive që nxirrte shteti shqiptar si psh., përbërja "sekret ushtarak" e disa vendeve ku do vendoseshin francezët me sheshe xhirimi e të tjera absurditete të tilla. Dhe pas gjithë këtyre pengesave, si për t'i "vënë vulën" një vendimi të paramenduar, pala shqiptare me anë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, (urdhri i zv.ministrit, Sokrat Plaka), me anë të një telegrami-shiferi tepër

sekret njoftonte ambasadat tona në Paris, Romë, Beograd dhe Athinë, ku thuhej: "Urgjente Dt.26.8.1982. TEPER SEKRET. SHIFRIMI. Koncepti: Në rast se paraqiten për vizë grupi i xhirimit të filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" i përbërë nga: 1. Michel Pikoli, 2. Hugu Nacin, 3. Domenigüe Tabuteau, 4. Jan Lui Millart, të mos u jepet vizë. Po të paraqiten, na njoftoni dhe prisni përgjigjen tonë".

Por cila ishte arsyeja kryesore që pala shqiptare u nxirrte pretendime pas pretendimeve francezëve dhe a kishte mundësi reale shteti shqiptar për t'i qëndruar korrekt kontratës që kishte lidhur me shoqërinë filmike "FILMS 66"? Nga shumë burime të besueshme bëhet e ditur se pretendimet e palës shqiptare për realizimin e filmit s'ishin gjë tjetër veçse pretekste subjektive të ngritura artificialisht për "tua nxirë jetën" francezëve, aq sa i

Kontrata për xhirimin e "Gjeneralit..." të Kadaresë, që largoi francezët nga Shqipëria

Klauzola e kontratës: Filmi duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe marrëveshjen e bërë nga autori i romanit, Ismail Kadareja me "FILMS 66".






që i kemi publikuar më herët (korrik-gusht 2017, "Gazeta Shqiptare"), në numrin e sotëm po publikojmë për herë të parë kontratën e palës shqiptare për xhirimin në Shqipëri të filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", kontratë e cila nuk u firmos kurrë nga shoqëria filmike franceze, "FILMS 66", e cila pas kësaj u tërhoq dhe i zhvendosi xhirimet në jug të Italisë, ku dhe e realizoi filmin në fjalë me protagonist aktoren e famshëm italian, Marchello Mastrojanni. Ashu siç do të shohim edhe nga faksimilet përkatëse, në kontratën në fjalë ka shumë shënime me shkrim dore të bëra nga zv.ministri i Punëve të Jashtme të asaj kohe, Sokrat Plaka, i cili në fund të kontratës ka shënuar: "Po për vetë filmin në tërësi, çdo marrim ne?"

KONTRATA
KINOSTUDIO "SHQIPERIA E RE", rruga "Aleksandër Moisiu", 76,



detyroi ata që të tërhiqeshin nga projekti i tyre për realizimin e filmit dhe më pas ta zhvendosnin atë në jug të Italisë, siç dhe ndodhi më pas. Thuhet se problemi kryesor ishte çështja "Kadare", autori i skenarit të filmit, ndaj të cilit pikërisht në ato ditë, në një nga qelitë e hetuesisë të Burgut 313 në Tiranë (ku zhvillohej procesi hetimor i të ashtuquajturit "Grupi armiqësor i Mehmet Shehut dhe Kadri Hazbiut"), "porrëfëhej" ish-ministri i Shëndetësisë, Llambi Ziçishti, duke akuzuar edhe Kadarenë si pjesëtar i atij grupi. Por edhe pse dosja "Kadare" u mbyll, filmi "Gjenerali..." nuk u realizua dot dhe arsyet e vërteta nuk u thanë kurrë e nuk janë bërë ende publike edhe sot, pas 29 vjetësh nga shembja e regjimit komunist. Kjo gjë të paktën nga asnjë prej aktorëve kryesorë që u morën me "çështjen" e xhirimit të "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", ku shumë prej tyre jetojnë ende. Ndërsa, lidhur me disa nga pengesat artificiale dhe pretendimet e palës shqiptare jemi njohur nga disa dokumente





Në foto:
Aktori dhe përfaqësuesi i shoqërisë
filmike franceze "FILMS 66",
Michel Piçoli



Në foto:
KINOSTUDIO "SHQIPËRIA E RE"

Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar prej... nga njëra anë që më poshtë do të quhet shkurtimisht "Kinostudio" dhe "FILMS 66" 'Avenue Mac-Mahon' 75017 Paris, Francë, e përfaqësuar prej... nga ana tjetër, që më poshtë do të quhet shkurtimisht "FILMS 66", për:

Xhirimin në territorin e RPS të Shqipërisë nga ana e "FILMS 66" të filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" në kushtet e mëposhtme:

1. Kinostudio merr përsipër të krijojë kushtet e nevojshme në mënyrë që "FILMS 66" të xhirojë në territorin shqiptar pa ndërprerje nga data 14 tetor deri më 25 dhjetor 1982 episode të filmit të lartpërmendur, prodhim i "FILMS 66", duke vënë në dispozicion të kësaj të fundit, sipas kërkesave të saj, personelin teknik, objekte xhirimi dhe materiale që shënohen në lidhjet 1, 2 dhe 3.

Filmi është prodhim ekskluziv i "FILMS 66". Si rrjedhim, në titujt e filmit të lartpërmendur, personeli shqiptar dhe shërbimi i Kinostudio "Shqipëria e Re" nuk do të pasqyrohen.

2. "FILMS 66" merr përsipër që t'i paguajë Kinostudios, sipas kushteve të kësaj kontrate, shumën prej Fr.fr.....

3. "FILMS 66" do të sjellë në Shqipëri një grup xhirimi franko-italian (punonjës, teknikë dhe aktorë) jo më shumë se 37 veta, si dhe aparatura të ndryshme xhirimi, ndriçimi dhe materiale të tjera dhe katër automjete teknike me aparaturat përkatëse që shënohen hollësisht

në lidhjen nr.4.

Pikat kufitare të hyrjes e të daljes të personave të grupit të xhirimit dhe të mjeteve teknike të lartpërmendura do të jetë aeroporti i Rinasi dhe Hani i Hotit.

4. Pagesat që do të bëjë "FILMS 66" për shërbimet që do të kryejë Kinostudioja përsërkruhen hollësisht në lidhjen nr. 5.

5. "FILMS 66" detyrohet që listat e personelit të grupit të xhirimit francez dhe italian së bashku me gjeneralitetet përkatëse t'ia dërgojë Kinostudios 30 ditë para ardhjes së secilit person në Shqipëri, duke bërë në të njëjtën kohë edhe kërkesën për formalitetet e pasaportës e vizave në ambasadën e RPS të Shqipërisë në Paris apo Romë.

6. "FILMS 66" do të çelë pranë Bankës së Shtetit Shqiptar në favor të Kinostudios një kredi dokumentare të parevokueshme, të konfirmuar në gjithë shifrën prej Fr. Fr.....15 ditë para nënshkrimit të kontratës. Përdorimi i kredisë do të bëhet për kundrejt paraqitjes në Bankën e Shtetit Shqiptar të dokumenteve si më poshtë:

- Faturës së paraqitur nga Kinostudio në dy kopje.

Situacionit javor të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve.

Pagesa do të kryhet në fillim të çdo jave paraardhëse. Pagesa e karburantit do të bëhet për çdo javë konkretisht sipas konsumit që do të pasqyrohet në situacionin jav-

or dhe sipas çmimeve të caktuara në Lidhjen nr. 1.

7. Xhirimet e filmit do të kryhen nga data 14 tetor 1982 deri më 25 dhjetor 1982.

8. "FILMS 66" merr përsipër t'i dorëzojë pa pagesë Kinostudios një kopje dubël-negativ të filmit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", me përfundimin e filmit, për përdorim brenda vendit.

9. Filmi i përfunduar duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe marrëveshjen e bërë nga autori i romanit, Ismail Kadareja me "FILMS 66".

10. Në rast se "FILMS 66" nuk do të respektojë kushtet e kësaj kontrate, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur pa paralajmërim dhe "FILMS 66" do të përballojë shpenzimet e bëra deri në datën e prishjes së kontratës.

11. Mosmarrëveshjet eventuale që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, palët do të përpiqen t'i zgjidhin me bisedime.

Lidhjet nr. 1, 2, 3, 4, 5 janë pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate.

Kjo kontratë u përpilua në Tiranë, më datën....., në gjuhët shqip e frëngjisht në 4 origjinalë për secilën gjuhë, duke pasur të dy tekste fuqi të barabartë.

Secila palë merr nga një ekzemplar në secilën gjuhë.

Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri më 31 dhjetor 1982.

PER KINOSTUDION PER "FILMS 66"

LETËR E HAPUR

“Im atë dëshiron të më kthejë në një skllave për mullahët, kriminelë të Iranit”

Nga Somayah Mohammadi

Në intervistën e tij me "Gazetën Shqiptare", Mostafa Mohammadi përpiqet të më paraqesë mua, vajzën e tij, Somayah Mohammadi në moshën 38-vjeçare, si një grua të mashtruar dhe pa fuqi vullneti. Një grua që nuk e ka forcën për të vendosur për veten e vet dhe si pasojë duhet që i ati t'i marrë të gjitha vendimet për të. Kjo nuk është e habitshme. Im atë është punonjës dhe kontrollon nga Ministria e Inteligjencës së regjimit të mullahëve, njerëz që nuk e vlerësojnë apo respektojnë zgjedhjen dhe vullnetin e një gruaje. Në Sharia-në e mullahëve, inteligjenca e një gruaje është sa gjysma e asaj të një burri. Si pasojë, është burri, ai që duhet të vendosë gjithmonë për një grua. Edhe po të dojë të udhëtojë, gruaje duhet të kërkojë lejen e të shoqit apo të të atit. Po për këtë arsye, gratë nuk mund të jenë gjykatëse. Ato janë të brishta dhe u binden ndjenjave dhe "nuk kanë mjaftueshëm urtësi dhe logjikë" për të qenë gjykatëse. Në mentalitetin e mullahëve iranianë, gratë janë baras me të miturit dhe maniakët. Im atë dëshiron të më shesë si skllave të mullahëve për para. Ndërkohë që unë jam krenare që i kam marrë vetë vendimet e mia gjithë jetën, në liri të plotë. Unë e kam zgjedhur vetë se si të jetoj, në mënyrë që të mund t'i ndihmoj sa më shumë bashkatdhetarët e mi, t'i ndihmoj që ta çlirojnë veten nga mizogjinia dhe diktatura e mullahëve në Iran. Në intervistën time me "Gazetën Shqiptare" zbulova fakte të pamohueshme për sa u përket 15 viteve të torturës psikologjike nga Mostafa Mohammadi me urdhër të regjimit të mullahëve. Dhe, në një letër drejtuar ministrit të Brendshëm, z. Fatamir Xhafaj, kam bërë kërkesë që ky keqbehës i inteligjencës iraniane të përjashtohet nga Shqipëria. Por në intervistën e tij, kur gazetari e pyet Mostafa Mohammadi-n për këto fakte që kam zbuluar unë, ashtu siç bëjnë edhe shefat e tij, në vend të përgjigjes, ai fillon me shpifjet dhe gënjeshttrat kundër MEK duke përdorur të njëjtën kulturë si ajo e mullahëve. Për më tepër, ai më përshkruan si një grua pa forcë vullneti, e cila thjesht ndjek urdhrat. Kur gazetari i thotë që Somayah Mohammadi thotë se "ju jeni agent i Ministrisë iraniane të Inteligjencës. Cila është përgjigjja juaj?", ai jo vetëm që nuk i përgjigjet pyetjes, por vazhdon me gënjeshtra të tjera për MEK. Reporter i thotë që Somayah Mohammadi e refuzon pretendimin e tij se MEK e mbajnë peng atë. Ai përgjigjet se vajza e tij është në një organizatë radikale dhe çdo gjë që bën në këtë organizatë i është diktuar. Gjithashtu, kur i thuhet që Somayah Mohammadi thotë se prapa tij është regjimi iranian dhe ai është agent i inteligjencës iraniane, ai përgjigjet, "ku e di vajza ime se unë jam agent iranian? Ajo ka jetuar në burgun e MEK për dy dekada".

"Ambasada e mullahëve iranianë në Tiranë duhet të mbyllet"



Kur reporter i kujton se Somayah ka bërë kallëzim kundër tij në polici, ai përgjigjet se edhe ai kishte bërë kallëzim katër ditë më parë dhe tani MEK kanë frikë. Kjo lloj pikëpamjeje ndaj grave, sjelljeje dhe fabrikim gënjeshtresh nga një baba kundër vajzës së tij do të ishte një turp i madh. Por, në rastin e Mostafa Mohammadi-t është krim, pasi ai po i shërben regjimit iranian duke ndihmuar shtypjen dhe ekzekutimet brenda Iranit. Unë nuk kam asnjë vlerësim për Mostafa Mohammadi-n. Ai nuk do t'ia dijë për mua. Nga ana tjetër, për

shkak të qëndrimit tim politik dhe anëtarësimi në opozitën kryesore demokratike kundër fashistëve fetarë iranianë, unë vlerësohem saktë nga ky regjim. Duke më abuzuar mua, Mostafa Mohammadi i jep ndihmën më të mirë regjimit iranian. Me ndihmën e Ministrisë iraniane të inteligjencës, Mostafa Mohammadi ka bërë një video për mua. Ky film përsërit të gjitha gënjeshttrat, me qëllimin ta diskreditojë organizatën MEK, pjesë e së cilës unë jam. Mullahët ia tregojnë këtë video nëpër burgje të burgosurve politikë, në mënyrë që

ata të distancohen nga MEK. Nëse nuk distancohen, ata torturohen, madje edhe ekzekutohen. Kjo mund të jetë e vështirë për t'u besuar, por është e vërtetë. Lexuesit tuaj mund të jenë duke pyetur veten se ç'i duhen regjimit iranian intervistat dhe gënjeshttrat e Mostafa Mohammadi-t, kur ato nuk arrijnë të mashtrorjnë popullin e mirë-informuar shqiptar? Për çfarë arsyeje e vendos ambasada iraniane atë në një nga hotelat më të shtrenjtë të Tiranës dhe i jep gjithë ato lehtësira e para? Dhe, pse nxitet ai nga mullahët, të bëjë këto

sjellje dhe intervista në Tiranë? Përgjigjja është e thjeshtë. Edhe nëse nuk kanë sukses në Tiranë, të paktën, torturoesit e regjimit iranian i përdorin të gjitha këto intervista nëpër burgje për t'u bërë presion të burgosurve politikë. Regjimi iranian njihet botërisht si një regjim terrorist, që mbështet kriminelët. Irani ka numrin më të madh të ekzekutimeve në raport me popullsinë e tij, sipas "Amnesty International". Për mbijetesën e tij, regjimi i mullahëve ka ekzekutuar mbi 120,000 anëtarë të MEK dhe liri-dashës të tjerë. Vitin e shkuar, Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut bëri thirrje për hetime mbi masakrën e të burgosurve politikë të vitit 1988 në Iran. Gjatë verës së 1988-ës, regjimi iranian ekzekutoi mbi 30,000 të burgosur politikë nga MEK dhe disidentë të tjerë politikë. Gjithashtu, për t'ua thyer moralin të burgosurve politikë, gratë përdhurohen sistematikisht në burgjet iraniane. Torturoesit kanë një urdhër zyrtar (fatëa)////// të lëshuar nga Khomeini dhe mullahët të tjerë, urdhër i cili u jep lejen për t'i bërë këto gjëra. Tahere Tolou, një nga mijëra gra të vrara nga regjimi i mullahut të Iranit. Veprimtaritë e Mostafa Mohammadi-t në Shqipëri kundër meje dhe MEK janë për të kompensuar për dëshimin e tentativës terroriste marsin që shkoi kundër MEK në Tiranë, tentativë që drejtohej nga ambasada iraniane në Tiranë. Në këtë ngjarje, dy terroristë të regjimit iranian janë arrestuar nga autoritetet shqiptare dhe janë deportuar në Iran. Kjo është arsyeja pse, për sigurinë e popullit shqiptar, ambasada iraniane në Tiranë duhet të mbyllet dhe agjentët e Ministrisë iraniane të Inteligjencës që është e stacionuar në këtë ambasadë, të cilët kanë në duart e tyre gjakun e popullit iranian dhe marrin pjesë në terrorizëm, duhet të përjashtohen. Makineria e fabrikimit të gënjeshtrave nga regjimi iranian dhe kryesat e tyre kundër opozitës arzusore demokratike nuk marrin fund kurrë. Që nga dhjetori i shkuar, në Iran kanë filluar demonstratat dhe protesta mbarëkombëtare me direktiva nga MEK. Regjimi do të bjerë së shpejti. Ndërsa përplasjet midis protestuesve dhe forcave të sigurisë në Iran intensifikohen çdo ditë e më shumë, përdorimi i një elementi tashmë të diskredituar dhe famëkeq si Mostafa Mohammadi kundër MEK mund të konsiderohet si përpjekja e fundit e mullahëve për mbijetesë në tatëpjetën e vdekjes së tyre. Mullahët u bashkohshin së shpejti paraardhësve të tyre diktatorë e kriminelë në historit si Nero dhe Hitleri.

Me respekt, Somayah Mohammadi





Cili ishte Pal Gazulli, humanisti dhe ambasadori i Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Raguzë dhe Itali

NGA GJON MARKU

Krahas Gjon Gazullit në shekullin e XV një meritë të çmuar dhe të vyer ka dhe vëllai i tij Pali (Pavlo de Gazullis). "Ai është i njohur si "orator" (i deleguar) i Skënderbeut dhe si "miles", që do të thotë sekretar, ose madje dhe zëvendës

i tij. Kjo tregon njëheri dhe për aftësinë e tij të jashtëzakonshme dhe për pjesëmarrjen e tij në luftë kundër turqve" shkruan Prof. Jas-har Rexhepagiq.⁽¹⁾ Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar Pal Gazulli (rreth 1405-1470) cilësohet si Humanist shqiptar i shek. XV, diplomat, pedagog, orator dhe një ndër bashkëpunëtorët e

Skënderbeut.⁽²⁾ Pal Gazulli (1405-1470) (në burimet e kohës: Paulus Gazullus) lindi nga prindër të mërguar në Raguzë ku punët i kishin vajtur mbarë. Bashkë me vëllanë e tij më të madh, Gjon Gazullin (Johannes Gazullus) kreu studimet e larta në Padovë në një nga universitetet më të shquara të shek. XV. Pasi për-

funduan studimet, të dy vëllezërit u kthyen në Raguzë ku hynë në rrethet e intelektualëve humanist të Republikës Dalmatike. ⁽³⁾ Kur në Shqipëri mori hov lufta çlirimtare nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, të dy vëllezërit hynë në shërbimin të diplomacisë, me ndryshim se Gjoni, ndërkohë astronom i njohur, u bë

Ambasador i Raguzës i dyti, Pali, i cili për disa kohë kishte shërbyer si rektor i shkollave të Republikës (detyrë e ngjashme me ministrin e arsimit) u bë ambasador i Skënderbeut, madje dhe supervisor (mbikëqyrës) i depozitave financiare që kishte kryekapitani shqiptar në Bankën e Komunës së Raguzës. ⁽⁴⁾

→ Vizion në faqen 14

{ Në këtë numër: LAWRENCE M.BENSKY, GJON MARKU, AG APOLLONI PËR PRIMO SHLLAKUN, ROLAND GJOZA, SOKRAT PASKALI, FLORIAN ÇANGA }

A

ARGUMENT

Ky personalitet që do të ishte ambasadori i Skënderbeut nuk vinte nga hiçi. Pal Gazullit ishte rektor i shkollave të Republikës dhe në një dokument, që ruhet në Arkivin e Dubrovnikut, e që daton në viti 1442, thuhet se Dhoma e Vogël e Dubrovnikut kishte vendosur të merrte në shërbim Pal Gazullin, vëllain e mësuesit Gjon Gazulli, si mësues dhe rektor të shkollave të qytetit, për dy vjet 1442-1444. Për këtë punë iu caktuan lokale të veçanta, si dhe rroga prej 250 perperësh në vite. Si thuhet në këtë dokument, Pal Gazulli ishte "njëri i zgjuar dhe i ngritur" që u zgjodh rektor i shkollave të Dubrovnikut fill pas mësuesit humanist Filip de Diversis (1434-1440), i cili ka meritën për zhvillimin e shkollave të Dubrovnikut"...

Pal Gazulli humanisti dhe ambasadori mendjendritur i Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Ragusa dhe Itali

NGA GJON MARKU

Vijon nga faqja 1

Për veprimtarinë e Pal Gazullit si rektor i shkollave të Republikës "... tregon edhe një dokument, që ruhet në Arkivin e Dubrovnikut, e që daton në viti 1442. Sipas këtij burimi, dhoma e vogël e Dubrovnikut kishte vendosur të merrte në shërbim Pal Gazullin vëllain e mësuesit Gjon Gazulli, si mësues dhe rektor të shkollave të qytetit, për dy vjet 1442-1444. Për këtë punë iu caktuan lokale të veçanta, si dhe rroga prej 250 perperësh në vite. Si thuhet në këtë dokument, Pal Gazulli ishte "njëri i zgjuar dhe i ngritur" që u zgjodh rektor i shkollave të Dubrovnikut fill pas mësuesit humanist Filip de Diversis (1434-1440), i cili ka meritën për zhvillimin e shkollave të Dubrovnikut".⁽⁹⁾

Pal Gazulli ishte i vetmi ambasador i Skënderbeut që qëndroj vazhdimisht në selinë ku ishte akredituar. Ai shkëputej nga selia e Raguzës sa herë që merrte porosi nga Skënderbeu për të kryer misionë diplomatike.

"Se fisi i gazullorëve kje jetik, e në ç'kohëna të lashta bujar, nuk mund të mohohet, kurse Pal Gazulli ishte besnik i të madhit Skënderbeg, të cilin, ndoeshqonite ndo shkote n'emen të tij në Romë te papa, e të cilit papa, nëpërmjet Zyrtarve të naltë të vet, i dorëzonte 2000 dukatë për Skënderbegun, por si ndihmë për luftën kundër Turqve.⁽⁶⁾ Shkruhet në revistën "Kumona e së djellës" në vitin 1938.

Administrata financiare ishte pa dyshim e thjeshtë dhe numerimi i funksionarëve tepër i pakët. Në krye të këtij dikasteri në fillim të sundimit të Skënderbeut ishte Ninc Vukosaliq. Disa vite më vonë dalin dhe emrat e dy pjesëtarëve të tjerë të sektorit të financave të shtetit të Skënderbeut, Rajani dhe Pal Gazulli e pas tij At Dhimiter Frangu.

"Jo me pak aktiv është treguar Pal Gazulli; dhe ai u shqua në kryerjen e transakcioneve financiare dhe të dërgatave të vështira; kështu në shtator 1453 ai tërhoqi një shumë të madhe nga depozita raguziane e despotit serb Gjergj Branković.⁽⁷⁾

Prof. Dhimitër Shuteriqi pohon



se: më 25.IX.1453 Pal Gazulli e Theodor Jafet-i, ambasadorë të Skënderbeut, janë në Raguzë. Vendoset t'u epen 100 livra nga argjendi i depozituar aty (prej despotit serb), me shkresën e despotit.⁽⁸⁾ Dihet se Gjergj Branković i depozitonte një pjesë të thesarit të tij në ar e argjend pranë Republikës Dalmate.⁽⁹⁾

Para tyre, po në shtator, Skënderbeu kishte dërguar në Raguzë një tjetër ambasador të vetin "peshkopin e Arbëris" me sa kuptohet, pa ndonjë sukses.⁽¹⁰⁾

Siç del nga vendimi i këshillit të Raguzës, më 25 shtator 1453 thuhet: "Së pari t'i jepen zotit Pal Gazulli e Theodoro Jafetit, ambasador të Skënderbeut, nga sasia e argjendit... që është depozituar në komunën tone".⁽¹¹⁾

Prof. Jahja Drançolli në librin e tij Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shek. XV pohon se: më 25 shtator 1453 qeveria Raguziane i dorëzoi Pal Gazullit afro 35 kilogram argjend që kishte marrë nga depozita e Stefan Brnkaviqit.⁽¹²⁾

Po në këtë vit (sipas një dokumenti që mban datën 8.II.1453), Pal Gazulli u bë në Raguzë si misionar i princit Vladislav Kosaçës. Në këtë kohë Raguzia kishte rënë në zjarrin e luftës me princin Stefan Vukçiq Kasaça (1451-1454).⁽¹³⁾

Në fillim të vitit 1454 Skënderbeu, tepër nevojtar për ndihmë

Administrata e Skënderbeut

Administrata financiare ishte pa dyshim e thjeshtë dhe numerimi i funksionarëve tepër i pakët. Në krye të këtij dikasteri në fillim të sundimit të Skënderbeut ishte Ninc Vukosaliq. Disa vite më vonë dalin dhe emrat e dy pjesëtarëve të tjerë të sektorit të financave të shtetit të Skënderbeut, Rajani dhe Pal Gazulli e pas tij At Dhimiter Frangu.

"Jo me pak aktiv është treguar Pal Gazulli; dhe ai u shqua në kryerjen e transakcioneve financiare dhe të dërgatave të vështira; kështu në shtator 1453 ai tërhoqi një shumë të madhe nga depozita raguziane e despotit serb Gjergj Branković.

ushtarake, pasi ushritur turke arritën në viset shqiptare dhe po i afroreshin Durrësit, nisi për në Romë dhe në Napoli Pal Gazullin.

Më 29.III.1454 Alfonsi V lajmëron Skënderbeun, se me Pal Gazullin i dërgon një ndihmë nga Papa dhe se do ta ndihmojë vetë. Së shpejti do të dërgojë dhe mëkëmbësin Ramon de Ortafa, i cili do të sjellë dhe ndihmë në një masë që Skënderbeu të mbetet i kënaqur. Pali do të informojë me hollësi.⁽¹⁴⁾ Alfonsi njofton dhe për ndihmën që do t'i dërgonte për së shpejti Papa nga Roma.⁽¹⁵⁾

Më 18.VII.1456 Skënderbeu i shkruan Dukës së Milanos. E falenderon për pritjen që i ka bërë Pal Gazullit, ambasadorit të tij, në kthimin nga Burgonja. Ai gëzohet për paqen dhe krushqinë midis tij dhe Alfonsit. I dërgon një kal dhuratë me anë të Gjergj Petriçi.⁽¹⁶⁾

Leter që ruhet në arkivin e shtetit të Milanos ku më parë kishte

oborin e Sforzave ambasadori tjetër i Gjergj Kastriotit Pal Gazulli, në kthim e sipër nga oborri i Burgundit, përdërisa në korrik Skënderbeu do ti shkruante përsëri dukës Francesco Sforza për ta falenderuar për pritjen që i kishte bërë atij nëpërmjet një të dërguari tjetër. I dërguari i korrikut ishte përsëri një klerik, Gjergj Petriçi, më sa duket po ai (George Petri abbas) që do të dërgohej vitin e ardhshëm nga Skënderbeu të Papa Kalisti II për të kërkuar ndihmë kundër turqve ose Gjergj Pelini sikurse ja lexon emrin Hopfi i shfaqur në lidhjen e paqes së 1448-s me gjasë si përfaqësues i Nikoll Dukagjinit dhe jo i Skënderbeut.⁽¹⁷⁾Në rrafshin politik situata kritike e 1457-s e kishte shtritur Gjergj Kastriotin të orvatej për një hapje më të madhe të aleancave për ç'i përket politikës ushtarake. Orvatja e re synonte Dukatën e Burgundit. Më 1456 Skënderbeu dhe Duka i Burgundit qenë ndodhur përkrah në projektin ushtarak të përgatitur nga Papa për ekspeditën në lindje. Atë vit është regjistruar të ketë qenë përsëri në oborin e Filip-të Mirrit si Ambasador Pal Gazulli.⁽¹⁸⁾

Pa më 1458 papa jep një shumë prej 50 florinjsh për Gjergj Kastriotin Abatit të Shën Mëris së Nderfanës dhe Palit të Gazullit (duhet të kenë qenë emisarët që i kishin qar papës lajmin e fitores tek Ujëti e Bardh) të cilët shoqëroheshin në oborin e tij nga kalorësi Johan Ov Nevpport. Serra, që ka lexuar aktet dokumentare origjinale dhe librin e llogarisë së Dhomës Apostullore.⁽¹⁹⁾

Dhimitër Shuteriqi pohon se: më 15.II.1458 Pal Gazulli, ambasador i Skënderbeut gjendet në Romë, ku i jepet një sudsidi fare i vogël për të zotin, vetëm 50 florinj. (Serra, në Archivostor.it.1956, 732. Pall, Rapportit it -alb.160, sh.154)

"Na zotni Gjergj Kastroti thirrur Skanderbeg i deshmojm kujdo që t'i përkasë e kujtudo t'i paraqitet kjo letër e jona e çilun e shkelun me vulen e unazes s'onë mjes nesh e komunës së Raguzës për punen e depozitimit që ka depozitue në komunën e Raguzës kancelari i jonë Rajani e zotni Pal Gazulli për urdhën t'onë, se kena tërhek 900 dukat ara prej fort të ndritunit Princ e prej se lartës komunë të Raguzës me anë të sekretarit t'onë Ninc Vlukosaliqit e për

Në vitin 1457 ishte ndalur në

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Qëndrimi jo i pak njerëzve, lidhur me Teatrin Kombëtar, përkon me një gjë. Hapësira që i korrespondon teatrit të mbetet e teatrit dhe aksesorëve të tij po ashtu. Por, ndërsa njëra palë lufton dhe militon që teatri të mos priset fare dhe të rikonstruktohet pikërisht me ngrahinën e vjetër, një pjesë jo e vogël tashmë është prezantuar me idenë e një teatri krejt të ri, porse sërish pa prekur hapësirën. Me këtë grup duket më e afërt dhe oferta e kryebashkiakut, por edhe mirëkuptimi i qeverisë aktuale.

Kjo betejë idesh dhe protagonizmi, që nisi fillimisht si paraqitje militantizmi mbledhi rreth vetes në një front të madh shumë emra të artit dhe jo vetëm, që ju ngjiten më vonë të tjerë personazhe. Ballafaqimi i parë me kryetarin e Bashkisë nxori konfliktet e këtij fronti shumëngjyrësh, por edhe një sëmundje të vjetër të

Do ishte më e thjeshtë për të gjithë nëse Teatri Kombëtar duhet të qëndrojë atje ku është. Tirana e kullave ka vend plot aty ku po synon të bëhet apo në Tiranën moderne që po planifikon të marrë jetës apo pas Bulevardit të ri. Një referendum i qytetarëve mund ta zgjidhte shumë më lehtë këtë rebus, që na ka kapur, por nga ana tjetër do bënte për herë të parë që qytetari të merrte në dorë ligjërisht fatin e një veprë të kryeqytetit të shqiptarëve...

Po banalizohet lufta për teatrin?!

njerëzve të artit, që shpesh nuk ndajnë dot individin shoqëror me individin aktrues. Si zakonisht mizëria e njerëzve që kërkojnë protagonizmin e panë si hapësirë të paanë që të shprehin veten duke treguar mbështetjen...me qëllimin për të fituar kredite sociale ose më qartë pikë... Anipse artikulet patetike të shumëvës syresh shpesh e ulnin kauzën para syve të njerëzve. Për hir të së vërtetës, kjo mbështetje mjaftoi gjithësesi që protesta të mbante kaq shumë ditë. Veçse në ditët që po jetojmë, një gjë mbetet realisht pezull, cila është dhe do të jetë rezultantja e kësaj lufte! Për fat, presidenti i vendit Ilir Meta me tagrin si garantuesi i kushtetutës gjeti shumë shkelje dhe këtë ua kumtoi zyrtarisht autoriteteve të ekzekutivit dhe atyre lokale, duke i dhënë me këtë rast një mësim të mirë sa i përket rasteve të ligjeve. Paqja se politika



vazhdon ta quajë si pabesi dhe madje ka vendosur një afat, që hiç mos më pak do të thotë se mbeten vetëm 35 ditë nga vendimi për ta prishur teatrin.

Këtu është futur banaliteti, që ka përfshirë shumë aktorë, politikanë, personazhe të jetës sociale dhe të tjerë. Dhe, ndodh, që ata që i kanë dhënë jetës kulturore, tash-

ti thjesht për të qenë mirë me një konjunkturë apo me tjetrën çfarë nuk lënë pa thënë për njëri-tjetrin, kurse letra si epistolarë shkëmbejnë personazhe të ndryshëm për të treguar veçantinë e tyre.

Do ishte më e thjeshtë për të gjithë nëse Teatri Kombëtar duhet të qëndrojë atje ku është. Tirana e kullave ka vend plot aty ku po synon të bëhet apo në Tiranën moderne që po planifikon të marrë jetës apo pas Bulevardit të ri. Një referendum i qytetarëve mund ta zgjidhte shumë më lehtë këtë rebus, që na ka kapur, por nga ana tjetër do bënte për herë të parë që qytetari të merrte në dorë ligjërisht fatin e një veprë të kryeqytetit të shqiptarëve. Kjo do t'i vinte fre banalitetit, por do të mbyste dhe qerthullin e disa njerëzve që duan të pengojnë gjithçka thjesht për interesat meskine të tyre. (Milosao)


përforcim ma të madh un kanceljer Ninci e kam shkruar me dor t'eme në qytetin e Raguzës e për urdhën të zotnis s'em Skanderbegut. Shkrua në vjetin e lindjes së Krishtit 1458 me 13 Qërshur shkruhet ne hyllin e Dritës në vitin 1940.⁽⁶⁴⁾

"Në mbështetje të tri dokumentave (që mbajnë datat 17.II; 2.IV dhe 13.VI. 1459 të shkruara në alfabetin cirilik, të cilat ruhen sot në Arkivin e Dubrovnikut), Palin e ndeshim n Raguzë si të deleguar të Skënderbeut. Sipas vendimit të Senatit Raguzian që mban datën 27.II. dhe 2.IV.1459, Pali terhoqi 500 dukat nga depozita e tyre në Raguzë, në mënyrë që kjo shumë të shkonte në llogari të despotit Gjurgaj Brankoviqit. Pagaesja u bë permes komunës Raguziane dhe me pjesmarrje të Palit, si i deleguar i Skënderbeut, dhe të Nincit. I deleguar i despotit serb nga poklada e njejtë e Skënderbeut, e cila ruhej në arkën shtetërore raguziane, më 13 qërshor Nincit iu pagua dhe një shumë prej 900 dukatësh.⁽⁶⁵⁾

Gjithashtu në "Hyllin e Dritës" në vitin 1940 shkruhet ... se Pal Gazulli tërheq nga Dubrovniku 1001 dukatë për Skënderbeun "... kjen tërheq prej depozitimit qi teproi edhe 1001 dukatë prej 12400 dukatëve të depozitimit të naltpermendur nuk tepron ma kurgja as nuk tepron ma kurgja prej që do depozitimi tjetër qi asht ba në komunën e Raguzës përveç dashtënis e miqesis. E për me e përforcue ket leter une Nince e kam shkruer per urdhen te zotni Shkanderbegut. Kje shkrua kjo flet në vjetin e të lemit të krishtit 1459 me 13 mars"⁽⁶⁶⁾

Po nga i njëjti burim nëpërmjet Pal Gazullit Skënderbeu tërheq nga Dubrovniku 500 dukatë të tjera më 2 prill 1459.

Për shkak të sigurisë, në Raguzë i depozitoj Gjergj Kastrioti mjetet e veta financiare. Por prej



Ojron Gazulli



Pal Gazulli para senatit të Venedikut

Në qershor përsëri në Romë, në dhjetor 13.XII.1463 paraqitet para senatit të Venedikut. (31) Pal Gazullit ambasadorit të Skënderbeut, Senati i Venedikut i pergjigjet për kërkesën e të zotit. Nuk mund t'i dërgojmë ushtarë, dhe pse i kanë premtuar. Brenda 2-3 muajve do t'i dërgojnë të hollat e nevojshme, për njerëzit e tij "që ti shërbejnë sa me mirë". S'kanë menduar aspak të dërgojnë në Shqipëri provizorin, veçse për të biseduar me madhërinë e tij për ndihmat e nevojshme.

këtëj ka mundur ti tërheqë mjetet në shtete të ndryshme sidomos Italia, Hungaria dhe Austria. Nga banka e Raguzës vetëm gjatë vitit 1459, Pal Gazulli dhe Celniku Rajan kishin tërhequr një shumë prej 2400 dukatësh.⁽⁷⁷⁾

Pal Gazulli më 1460 gjendet në afërsi të Skënderbeut, në skelën e vogël të Shufadës.⁽⁸⁰⁾

Pali doli edhe një herë para qeverisë raguziane dhe ardhja e tij lidhet me autoritetin e Skënderbeut. Këtë e gjejmë në Raguzë më 28.II.1461 ku Rektori i Këshillit të

vogël obligohet t'i përgjigjet Palit, të cilin e kishte dërguar Skënderbeu lidhur me strehimin e familjes së tij në Raguzë në rast rreziku nga osmanët.⁽⁸⁹⁾

Në mars më 28.III.1461 zhvilloi sërish bisedime me zotërinjtë e këshillit të Raguzës. Senati i Raguzës lejoi Rektoren e Këshillit të Vogël t'i përgjigjet Ambasadorit të Skënderbeut, Pal Gazullit. (Radonic 203)⁽⁸⁰⁾

Në qershor përsëri në Romë, në dhjetor 13.XII.1463 paraqitet para senatit të Venedikut. (31)

Pal Gazullit ambasadorit të Skënderbeut, Senati i Venedikut i pergjigjet për kërkesën e të zotit. Nuk mund t'i dërgojmë ushtarë, dhe pse i kanë premtuar. Brenda 2-3 muajve do t'i dërgojnë të hollat e nevojshme, për njerëzit e tij "që ti shërbejnë sa me mirë". S'kanë menduar aspak të dërgojnë në Shqipëri provizorin, veçse për të biseduar me madhërinë e tij për ndihmat e nevojshme.

Skënderbeu kërkon përgjigje të prerë rreth galerave dhe anijes, që ti dërgohen në portin më të përshtatshëm e më të mirë. Venediku në Dalmaci dhe Shqipëri ka shumë galera të cilave, u është dhënë urdher që të jenë në çdo rast në dispozicionin e tij, propë kërkesa e tij do të kënaqet, duke i dërguar një galerë të kontit të Kotorrit, të armatosur e që të jetë nën urdhrin e tij. Ai kërkon që konti i tyre të ketë gati, për të dy ose më shumë anije, "ku të jenë më të mirat", sa herë që ti kërkoen pa afat të caktuar. Kontit po i shkruhet

Kërkon të mos bëhet paqe me turqit pa e përfshirë edhe atë. Kështu do të bëhet, po dhe ai të mos bëjë paqe me ta pa pëlqimin e Sinjorisë. Po të dëbohet nga turku, ai, siç e kërkon, do të ketë provizionin që ka, për gruan dhe fëmijën, dhe 500 dukat vjetor më shumë. Janë të kënaqur që, në rast nevojë të tillë, ai ka zgjedhur për të banuar ishullin Lezina ose atë Kurçola ku do të ketë një banesë të përshtatshme për të.

Për pushtimet që mund të bëjnë Skënderbeu dhe Lek Dukagjini nuk flitet, pra të hiqen nga këtu kapitujt U pranua me 90 pro. Një këshilltar deshi që të thuhet se ata mund të mbajnë pushtimet që do të bëjnë, përveç Vlorës, Kaninës e Prgutit. Nuk u pranua.⁽⁹²⁾

Në Prill 1465 Pal Gazulli ishte para papës Pal II.⁽⁸³⁾ Skënderbeu ka dërguar në Romë Pal Gazullin për të marrë një subsid për të.⁽⁸⁴⁾ Sipas Regjistrit (85) (Senta Cruciat 1465-

72. f 126.) papa i kishte dhuruar dy mijë dukatë më 19.IV.⁽⁸⁶⁾ Pal Gazulli luajti një rol të rëndësishëm dhe në mbajtjen e lidhjeve diplomatike të shtetit të Skënderbeut me Hungarinë, nëpërmjet zyrtarëve të saj që vizitonin herë pas here Raguzën, ose të misioneve raguziane kur këto shkonin me detyrë në Hungari.

Literatura

1. Rrothepagja, Jashar. "Kontributi për njahjen e disa artistëve, shkrimtarëve dhe punëtorëve pedagoge shqiptarë të shekullit XV - Simpoziumi për Skënderbeun 9-12 maj 1968". fq. 389, Institut Albanologjik, Prishtinë, 1969.
2. "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar" Tirane 2008
3. Frasheri, Kristo. "Gjergj Kastrioti Skanderbeu Jeta dhe vepra (1405-1468)". Bolmeti Toona, Tirane, 2002.
4. Frasheri, Kristo. "Gjergj Kastrioti Skanderbeu Jeta dhe vepra (1405-1468)". Bolmeti Toona, Tirane, 2002.
5. Rrothepagja, Jashar. "Kontributi për njahjen e disa artistëve, shkrimtarëve dhe punëtorëve pedagoge shqiptarë të shekullit XV - Simpoziumi për Skënderbeun 9-12 maj 1968". fq. 389, Institut Albanologjik, Prishtinë, 1969.
6. Kumanova, siç thjeshtë, nr. 8, fq. 99-100. Shkudër, Gusht 1938.
7. Oliver Jens Schmitt "Skanderbeu", shqip nga Ardian Klosi fq.142.
8. Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", Radonic 70, fq. 189, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.
9. Drancolli, Jahja. "Raguzat në Kosovë", Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 189, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.
10. Plassari, Aurel. "Skanderbeu një histori politike", fq. 473, Tirane 2010.
11. Kristo Frasheri Skanderbeu dhe lufta shqiptaro turke në shekullin XV Veli Akademisë së shkencave të Shqipërisë Tiranë 2005, fq. 66
12. Drancolli, Jahja. "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV", fq. 75, "Rilindja", Prishtinë, 1984.
13. Drancolli, Jahja. "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV", fq. 75, "Rilindja", Prishtinë, 1984.
14. Radonic, T. Jorga, Natsel 49 Piskopit", Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 192, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.
15. Plassari, Aurel. "Skanderbeu një histori politike", fq. 473, Tirane 2010.
16. "Pali, Rapporiti i Ab. A. boton dok. E plotë lënësi Skanderbeu qahet Domenus provinçiarum Albanie"
17. Jug faksimen Radonic, tab. VII, i.cil, nr. 122 e mblodhi në dy tre metahe, Eshëri një document i fill rralisë autorik. Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 226, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane 2006.
18. Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 248, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.
19. shf për të dhe 15. VIII. 1456, Radonic 125
20. Oliver Jens Schmitt "Skanderbeu", shqip nga Ardian Klosi fq. 142.
21. Plassari, Aurel. "Skanderbeu një histori politike", fq. 510, Tirane 2010.
22. Plassari, Aurel. "Skanderbeu një histori politike", fq. 510, Tirane 2010.
23. Plassari, Aurel. "Skanderbeu një histori politike", fq. 510, Tirane 2010.
24. "Hyll i Dritës 1940, Nr 7-9, fq. 396, T. Geci, Mbi Strategjikëne Kastriotëve, ne: "Simpoziumi për Skanderbeun", Prishtinë, 1969.
25. Jahja Drancolli "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV" fq. 75, "Rilindja", Prishtinë, 1984.
26. Hyll i Dritës, Nr 7-9, 1940, F. 397
27. Radonic, "Dijarja Kastrioti Skanderbeg i Arbëria u XV vekut", p.108-110, No. 187.
28. Oliver Jens Schmitt "Skanderbeu", shqip nga Ardian Klosi fq. 143.
29. Drancolli, Jahja. "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV" fq. 75, "Rilindja", Prishtinë, 1984.
30. Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 269, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.
31. Oliver Jens Schmitt "Skanderbeu", shqip nga Ardian Klosi fq. 143.
32. "Ljubus X 293-4. Radonic 258 IV XIV 2634"
33. Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 299, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.
34. Oliver Jens Schmitt "Skanderbeu", shqip nga Ardian Klosi fq. 143.
35. Pali, Rapporiti i Ab.160, sh.154
36. Senta Cruciat 1465-72, f.126.
37. Shuteriqi, Dhimitër. "Moli i madh", fq. 303, Shqipëria Botuese Dituria, Tirane, 2006.

I

INTERVISTA

Në këtë intervistë të gjatë me autorin për periodikun kulturor kosovar kemi përzgjedhur disa pjesë të tij, që po i sjellim për publikun tonë... Autori tregon disa koncepte të krijimeve të tij, por edhe pikëpamjet mbi letërsinë dhe jo vetëm...

LIRIZMI ASHT SHIJA E SENDEVE QË IKIN

NGA AG APOLLONI

Në atë periudhë, kur u hesht gegnishtja, juve ju pamundësua të ligjëronit në fakultet, sado që pro jush fliste edhe një rekomandim i Eqrem Çabejt. Pse ndodhi ai refuzim dhe si e përjetuat?

PRIMO SHLLAKU: Prof. Çabej ka vdekë dhe ka marrë me vete shumë sekrete. Vërejtja ime asht që ai duhet t'i kishte shkruar diku. Ai ka qenë mik i babës tim dhe unë kam qenë një adhurues i tij në fakultet, edhe pse ai ka qenë në fundin e karrierës së tij të mësimdhënis dhe unë ndoqa një kurs si i jashtëm ose si ndigjues. Në atë kohë isha me shumë zell mësimi dhe me energji gjigande për punë. Ai i kishte thanë babës se kishte ndër mend që të më propozonte për t'u mbajtur në fakultet. Por kjo nuk ndodhi kurr. Kisha vërejtë asokohe se shkrodranët i sillnin rëndom në gjuhë-letërsi sepse i destinonin për mësues, një zanat ky që nuk e prekte establishmentin dhe se studentët shkrodranë në landët e shkencave politike, juridike, shoqërore nuk preferoheshin, madje as në anglisht sepse, mesa duket, të gjithë kta quadro destinoheshin për instancat pushtetmbajtëse dhe shkrodranët nuk duhet të ishin aty sepse, mendimi i gabuem i diktaturës, ata ishin liberalë dhe propropindimorë. Pra në fakultetin tonë kishte shumë shkrodranë studentë, por pak e aspak ndaleshin në fakultet, sepse ishin të papërshtatshëm për gjithçka që pushteti kulturor i asaj kohe kishte tinëzarisht ndër mend. Në fakultet mbahehin kryesisht nga zonat rurale, por gjithnjë nga Jugu. Kuptohet studenta të ekscelencës simbas parametrave vlerësues të asaj kohe.

Përveç Çabejt kam pohimin e kuartë edhe të së bijës së profesor Jup Kastriotit, Dianës, e cila vetëm para pak ditësh me rrefëse se i ati i saj, asokohe shef katedrë dhe njeri me influencë shkencore e prestigj integral, kishte ba dy herë kërkesë që të më afroonte në Universitetin e Shkodrës. Jo vetëm që nuk u miratue kurr kjo gja, por rrezik të mos e merrja vesht kurr se isha propozue.

Ky ka qenë fati im i mirë sepse, pa dashjen e tyne, ATA më rezervon statusin e outsider-it dhe unë u zhvillova lirish në një dimension tjetër. Ata më banë shumë mirë që nuk më tumirën pranë tyne, sepse unë isha i ngarkuem me pikëpamjet të tjera dhe ose do të dorëzohesha, ose do të digjesha. Singjerisht jam i kënaqun që ishte kështu, por meqë ata që më trajtuen kështu, nuk e banë që të banin këtë të mirë të cilës unë realisht i gëzohem, thjesht nuk ua di për ndër dhe nuk u kam gja borxh.

Përjetimi ishte rinor, sepse nga majat e andrrave rashë në fundin e realiteteve. Zonat ku shërbeva unë si mësues në dhjetë vjetet e parë të karrierës time të mësuesisë

ishin zona të mbushuna me njerëz të dënuem për fajë parapenale, persona të padëshiruem prej pushtetit ose edhe moralisht të kapun në flagrancë e abuzues të alkoolit e të seksit. Ky ferr ishte interesant në vetvete, sepse të dënuemit, në dëshprim e sipër, gjithnjë prodhojnë njëfarë lirie të vërtetë e të shijshme.

Platoni thoshte se çdo njeri kur dashurohet, bëhet poet. Në ç'kohë ratë në dashuri, domethënë në ç'kohë filluat të merreni me poezi?

Nuk kam fuqi me i dalë para emnit të Platonit, sepse ai din për të gjithë ne e për të gjithë kohët tona. Unë mbaj ende mend vargun ose vargjet e para që i shkrova me bojë jeshile mbi një fletore sovjetike me fletë të ndritshme. Duhet të kem qenë 8-10 vjeç kur shkrova kta dy vargje krejtësisht të kota dhe të amshata, gjithsesi pa lidhje mes tyne. Me siguri ndieva mrekullinë e daljes përjashta të diçkaje që ishte formue mbrenda meje pa leje e pa tutor, si shestim i vetvetishëm i një vetdije në zgjanim, si një sekrecion i paktë, por esencial, i njeriut që mund të isha në të ardhmen. Asokohe isha i dashunuem me shumë gjana njerësh dhe nuk zotnoja pothuajse asgja. Dashnia për kto gjana ishte një ekspeditë e pamundun mbi botën që i hapej një fëmije në një qytet të mbyllun e të traumatizuem nga ploja e fundit komuniste, por edhe nga morali i bigotëve të një kryevendi kthye tashma në provincë. E vetmja gja e madhe ish-in elementet e natyrës: mali, reja, lumi, vera e pushimeve, shkuemja me bujtë tek shtëpia e dajave, ekskursionet në kala me babën tim që zotnonte një sharm burrënor të rrallë e një magjepsje prej njeriu të ngjyem thellë me kulturë e dije alternative. Isha i magjepsun prej bukurisë së veçantë të nanës time, e cila, derisa u lindën motrat e vllau, më kishte idhull dhe karafil në okiolo. Më magjepste pranvera me lulet e aromat. Ma shumë se ngjyrat më transportonin aromat e botës: ajo e kumbullave dhe shtati prej nusje e një triditëshi i pemës së qershisë, aromat e zymbyllit që derdhnin në mue një morbozitet e një dorëzim të përafërt me të fiktin ose, ndoshta, edhe vdekjen. Më magjepsnin kambët e mia kur i shijja prej nalt dhe guditesha sesi ato nuk ngatërroheshin kur ecja e aq ma tepër kur vrapoja. Isha i dashunuem me qiellin kur çahet reja dhe shfaqej njolla e kaltërsisë në të, gati si dalje ose si derë drejt të panjohunës. Kur u rrita dhe po lexoja për Rafael Sancin, piktorin e madhe italian të Rilindjes, hasa një vend shprehjen "un lembo d'azzurro" që ishte sak-



tësist ajo që m'i shitonte sytë e mi e që paksa fëdullisht po m'i bashkonte ndjesitë e mia me ato të njerëzve që kishin jetue e krijuje para meje.

Saktësisht unë jam një njeri përjetësisht i dashunuem me gjithçka të bukur e sugjestive, me të gjitha ato sende që përmbajnë ose sugjerojnë të përtëjmen, me të gjitha ato sende që janë "presje" e jo "pikë". Përgjithësisht përvoja e vërtetë më autorizon të them se unë kam dashitë gjithnjë dhe fort kryesisht gjanat e pamunduna. Sapo ato baheshin të munduna (sepse kishte edhe nga ato), unë ndieja lodhje dhe në horizontin tim shfaqeshin sende e vegime që nuk

Marrja me letërsi

Marrja ime me letërsi e posaçërisht me poezi ka qenë një periudhë e gjatë e pambajshme mend. Ajo nuk ka qenë kurr nevojë, por një impuls i gatitun mbrenda meje përmes ngurrimesh, dembelish, mendjelehtësisht dhe kotësisht të pamëshirëshme. Po të isha për t'u dënuë përka kam shkruar e krijuar, e them pa asnjë farë ngurrimi se asgja nuk kam ba me qëllim. Ende zbuloj në shkrimet e mia referenca metafizike me jetën dhe realitetet që u qëndrojnë atyne si sfond. Procesi ka qenë komplet joracional dhe produkti ka qenë komplet produkt metafizik. Kjo më ka ndihmue që për shumë kohë të gjatë unë të mund të ekzistojta edhe si audiencë e vetvetes.

masazhi i anusit që dhimbja të fashitet sa ma shpejt. Me këtë due me thanë se unë kam pasë e kam dallim prej pulave. E kam ndie qysh shumë heret se ajo që unë mendoja ishte e papërshtatshme deri e përkundërt me zyrtaritetin verbal dhe krijimtar. Nuk më ushqente letërsia e kohës. Më lente një shije të thatë në gojë sikurse ajo shija e pluhrit që të futet gand në gojë në një situatë loje ose rrëzimi. Qysh shumë herët kjo letërsi më thoshte sesi nuk duhet të ishte letërsia dhe ma vonë sesi unë nuk duhet të shkruaja. Dhe kështu, duket, u nisa me shtruve shinat e rrugës time në heshtje e qetësi të plotë, e cila nuk asht aspak e ndryshme nga heshtja e qetësisë në të cilën shkruenin edhe shkrimtarët e poetët e zyrtaritetit. Secili izolohet në aktin e krijimit. Destinacioni asht tjetër mandej. Prandej edhe nuk kam dhanë përjashta ndonji figurë që të binte në sy. Por kur flisja me njerëz për tema nga ma të ndryshme, shpesh më thonin: "Pse nuk shkruen? Shkruaji kto se janë të thana bukur." Qoftë kur isha nisë, asaj udhe, kta inkurajime ma zavendësonin publikun real që ka arti kudo në botën e njerëzimit. E kisha një konfirmim dhe njëfarë vetverifikimi, por ajo që shkruaja mund të kishte vetëm temperaturën e mendimit tim, por kursese substancencë e asaj që thojta në publik.

Kur shkrimet e mia u banë shumë dhe nuk mund të mbahehin as përmendësh, as mbrenda një blloku me leter duhani si të Pipës, atëherë m'u desht me mendue për ta si për një fëmijë ilegal, ose, ma mirë me thanë, si për një shtatzani jashtamartesor. U mundova t'u gjej një vend dhe t'u caktoj një fat. Fati i tyne ishte një papërcaktim i madh. Po sikur të vdisja unë pa vdekë regjimi?

Po sikur regjimi të ishte jetëgjatë e unë vetëm jetënormal? Në 1981 më leu djali dhe thashë me lehtësi që për shumë kohë të gjatë unë të mund të ekzistojta edhe si audiencë e vetvetes.

Pse nuk botuat poezi gjatë regjimit? A shpresonit që regjimi do të binte shpejt, apo thjesht u flnisit në mënyrë migjeniane poezive që i shkruanit: unë djepi juej, ndoshta vorri juej?

PRIMO SHLLAKU: Ju jeni edhe botues dhe e kuptoni mirëfilli se akti i botimit nuk ka asgja të përbashkët si proces me krijimin. Botimi asht akt racional, ekonomik, menaxherial dhe paksa edhe punëfati. Ndër katundet tona kam ndigjue të thuhet prej grave të shtëpisë se pulat që kakarisin fort e gjatë e kanë ba vezën e madhe. Kuptohet se kakarisja asht një proces

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e zakonshme. Ishte interesant shkrimi i udhëtarit amerikan, që u botua përmes shikimit të një publicisti që jeton në Britani. Eksploruesi britanik Robin Hanbury-Tenison në faqet e një libri, kushtuar vendit, i ka përshkruar me thjeshtësi, singleritet dhe vërtetësi të admirueshme përshypjetet e kësaj aventure shqiptare, por gjithçka sfumohet nga përplasja e tij me ministrin shqiptar të kulturës së vitit 2007, që pati një fat shumë të keq në karrierë për shkak të korrupsionit dhe sjelljes jo të mirë... Redaktori u kujtua se e kishte takuar gati një dekada më parë dhe i kishte kushtuar një shkrim interesant atij...

Thanas Gjikes u la një hapësirë për Lazër Radin por shkrimi ishte disi e dobët edhe pse figura e të ndjerit është shumë interesante për t'u trajtuar. Autori në stilin e vet është më shumë përshkruar dhe nuk i shpëton ngujes për të dhënë përcaktime.

Ndue Ukaj na kish sjellë diçka lidhur me Kadarenë. "Qorrfermani" i tij, sipas autorit, e vë lexuesin përpara makthit të verbimit, pra, të çsyzimit, në një rrëfim mbresëlënëse, të mbushur me pikëllim, dhimbje, tension, tronditje, dashuri. Pak si e tepër në këtë kohë të shkruash sërish për



këtë libër, por çfarë mund të bësh ndryshe.

Kurse autori Durim Taci na kish sjellë një revieë të Agron Shalës, duke kaluar në refleksione interesante si përshembull... *Është ai çasti kur e ndjen se fuqia kalon nga ty, lexues. Tani, të takon ty t'i gjejsh librit të radhës një vend në raft, ta lësh bukur zbuluar, të paktën, që kur të rikthehesh nga rutina e zakonshme të mund ta vësh re e ta rimarrësh në dorë.*

Kurse poezitë e Luan Ramës bashkë me një etyd të tij duhen vlerësuar. Një elegji e bukur kushtuar kujtimit së të internuarve, mbajtur me një regjistër shumë të saktë të autorit, ku kujtimet ndërthehen me njëra-tjetrën duke na sjellë realisht një kujtim realisht të trishtë... Redaktori vetë shtoi një shkrim për Vetting, që nëse do zbriste në art, atëherë do të shikonim një masë lumi, që nuk bie më poshtë sesa në fushat e tjera të shoqërisë shqiptare... dhe kjo do na zhyste në një trishtim edhe më të madh e të paparashikuar për kinse heronjtë... Numri ishte relativisht i mirë, por faqosja ishte shumë e pafrumë.

mbi shqiptarët, të vdiste në dyshek, pra pa dhanë llogari. Kur u plotësue "profecia" ime me vdekjen në dyshek, unë prisja teposhen dhe zmontimin që në fakt erdhën edhe për shkaqe të jashtme globale.

Kam besue se regjimi nuk mund ta fitonte përjetësinë megjithëse ai kishte përmbyës të gjitha letrat njerëzore në tavolinë dhe nuk ngopej vetëm me jetën tonë, por synonte edhe jetën e atyne që nuk kishin lë. Kjo ishte kryeparanoja e regjimit. Baudelaire-i e shef Kohën si anmikun që i han të gjithë e të gjitha. Paranoja e tyne e shifte regjimin edhe si anmikun e Kohës, pra që do ta ndalonte atë të bajë punën e saj të Ndërrimit.

Mbase Migjeni kishte për veten ndiesinë e vdekjes së parakoshme dhe unë fjalët e tij "djep" e "ivorr" i lexoj në këtë çelës. Kjo ishte tragjika e Migjenit. Kurse gjendja ime ishte vetëm dramatikë, pra e dureshme me rrugëdalje. Historia me dha arsye deri aty ku mbërrinte liria ime. Krijimet e mia janë tashti mbrenda zonës së rrethuese me gahrin e të tjerëve. Aty nuk i ndihmoj dot.

Ndryshe nga diskursi komunist që karakterizohet nga rrëfimi i madh (grand narrative), letërsia juaj (poezia, proza dhe drama) preokupohet me jetën e vogël (la vie mineure). Çfarë është leximet tua në atë kohë që ndikuan në krijimin e veprës suaj si një kontrapunkt ndaj letërsisë së komunistit?

PRIMO SHLLAKU: Kjo pyetje juaj më sjell ndër mend një piktor amerikan që nuk po më kujtohet emni sepse ka shumë kohë që nuk e gjej në letërsinë piktorike. Ai piktorin pejzazhe deti të hapët dhe rruota të mëdha me rreze që, mes shumës e vurbuje që krijon zhytja, ato rrota fundoseshin ngadalë e solemnisht në ujë, tue të krijue një depresion jo të vogël emocional. Po kështu kam pasë fatin me hy në katedrale gotike nga ma të mëdhatë për kah dimensionet, kam pa piramidat e Egjiptit dhe Sfinksin e madh. E gjithë kjo teknologji dhe epistemologji arkitektonike synonte hedhjen në inferioritet të individit e të njeriut në përgjithësi karshi imazhit të Zotit, mbi të cilin do të ndërtohej moralit i një epoke ose i një shoqnie. Veprat e socializmit ishin edhe ato "madhështore", merreshin me përplasje epokale, me përballime, me titanomahi, madje edhe jeta e përditshme bombardohet me gjatantografi të klasës punëtore, të udhëheqësit, të kuadrigrës dogmatike. Edhe shifra 1 në parakalimin e 1 Majit duhet të ishte e naltë sa



nji obelisk. Krahas ktyne përbindshllëqeve njeriu real me mish e kocka dukej milingonë e bubrrecë. Ai duhet ta pësonte dhe ta pranonte mikroskopicitetin e tij përballë sistemit. Meqë regjimi dhe zyrtariteti i tij ishte ateist, atëherë dikush ishte kandidat për ta zavendësue Zotin në këtë formulë që kishte funksionue në të gjitha modelet e skllavnive. Letërsia nuk i shpëtoi ksaj lëngate. Gatuesit kanë emna dhe, ndonse diktatorët kanë mbarue ciklin e tyne biologjik, ata i mburrin veprat që flasin për atë sepe strukturalizmi na mëson se letërsia ka imanencën e saj.

Unë mendoj se njeriu asht ma shumë mikrokozmos sesa makrokozmos. Njeriu merr vlerë dhe gravitet kur shifet si univers sesa si neutrino në univers. Në jetën e përditshme të njeriut lejnë e vdesin të gjitha embrionet e ndryshme. Aty gjenden gjanat ende të pakontrafaktueme, ende të paprekuna e virgjna që mund ta shenjojnë epokën. Të tjerat janë sajesa metonimike që synojnë me prishë ligje e metafizikës njerëzore dhe me e kthye atë në genie vetëm natyrore: që ka frikë, që don me jetue me çdo kusht, që kënaqet me një bark bukë dhe asht gati me hëjë dorë prej çdo të mire shpirtnore që mund të prodhojë jeta në bashkësi.

Letërsia e mirë asht kapilare, ajo merrret me telat e hollë e jo me "nervat e çeliktat" të njeriut të Frankenstein-it. Raskolnikov i shkon disa herë në polici për t'u vetdenoncue për vrasjen e fajdexheshës, por duhet presioni i Sonjeshkës, asaj prostitutë që dorëkon shpëtim përmes ndëshkimit njerëzor: "Dorëzoju në polici, i thotë, dhe unë do të vij në Siberi me ty ta vuejmë dënimin së bashku." A ka ma minore se kjo? Kta dy të paemën, që simbas të gjitha gjasave, mund ta vazhdojnë

jetën e tyne të pashqetësuem, sepse janë, njeni përmbi çdolloj dyshimi e tjera, mbrenda çdo normaliteti. Po të mos ishte jeta e tyne minore që i çon të kryejnë aktin e vetdenoncimit e që do t'i lidhë ata me njerëzimin mbarë, çfarë arsyeje madhore do të kishte punë aty? Cila "raison d'état" mund të prodhonte një katharsis e një depresion të tillë tek audienca. Nëse kemi arsye të pohojmë se talentet vijnë në çdo kohë dhe se socializmi kontripton për t'i evidentue ata, po për të njëjtën arsye logjike dhe njerëzore duhet të pohojmë se talentet e spikatun mund të lidhen edhe me çashtje të gabueme. Ajo kohë ishte kohë e evidentimit të talenteve, por edhe kohë e shkërdhymjes së tyne. Unë ua qaj hallin shumë, sepse kaq shumë andrra e kaq shumë hove kah, e përjeta të përfundojnë në një shumkë të zbehtë që tek-tuk ndokënd edhe e ban me u skuqë. Ajo pjesë që vinte nga fsahati e ka alibinë gjithësesi, por talentet qytetare më duket se kanë pasë banak mes tyne e artit. Kur Kadareja i quen atë kohë "kohë e mbrapshtë", unë supozoj se atij i shpëton diçka nga vetdija e tij e mshefët se ai, cmos ndonjherë tjetër, e pranon firon dhe se edhe me atë ka ndodhë e najta gja: sa ma i madh talenti, aq ma e randë taksa e haraçit.

Po unë kam ekzistue dhe kam krijuë, nëse kam jetue e krijuë ndonji herë, si kontrapunkt i atij qytetnimit efemer. Kam ndie dhe kam veprue nën shtymjen e fortë të një paratletërsie të asaj zyrtarës të asaj kohë, tue u mundue me u "infektue" prej letërsive psikologjike ma të afërta të kontinentit, sikurse kishte ba ajo parardhësja. Rezultati asht në diskutim. Projekti im jo.

Poezia juaj nuk ka strukturë të rregullt, thelbi i saj janë

metaforat, jo format. Domethënë, poezia juaj absolutizon kualitetin e mendimit metaforik, prandaj ka një forcë magnetike që e tërheq lexuesin për ta përjetuar një gjendje lirike. Dihet se grekët e vjetër fazën e frymëzimit e quanin enthousiasmos (ἐνθουσιασμός), që nënkuptonte se në çaste krijimi ata ishin "n'duar të Zotit", të pavetëdijshëm, por ju zakonisht në çfarë gjendje emocionale dhe mentale shkruani poezi, pasi diku poezitë tuaja i keni quajtur "lule nate", që janë "prodhim i artit të madh të gjumit"?

PRIMO SHLLAKU: Kur njeriut nuk i mjaftonte bota natyrore që shifte dhe ndiente përqark, ai shpiku metaforën. Atashimi i krijimeve të mia me metaforën ma së shumti më pohon si njeri dhe kjo nuk ma ban qejfin pak.

Metaforat janë një rikrijim i botës dhe dublim i saj. Në kohën time të fillësave të krijimit bota që më rrethonte më binte shumë ngusht dhe unë kërkjoja zgjanim. Dhe m'u paraqit nevoja e madhe e arratisjes në një tjetër dimension, në pamundësi për t'u arratisë në një tjetër hapësinë që ishte aty, ekzistuese dhe e gatshme qysh nga krijesa.

Ju jeni i pari që, tue u marrë dashamirësisht me mue, keni konstatue edhe njisinë ndërtuese të shkrimeve të mia: metaforën. Koha e shkrimit për mue ka qenë e mbetet një mister. Unë e mbaj mend vetem vetëm para e mbas shkrimit. Koha e shkrimit asht një kohë e pajetueshme prej arsyes dhe vetdijës sime. Ajo asht një gjendje vetmimi ku qendrat e eksitueme të trunit gjejnë rrugën e krahëve, përfundojnë tek gishtat që shtërrojnë një laps ose rrahin një tasterë. Kaq di me dëshmue unë. Nuk e mistifikoj, por unë jam larg çdo

qëllimi, nijeti, projekti dhe arsyetimi. Qenia ime pikëzohet dhe unë mungoj për një copë herë nga kjo botë, pa e ditë se ku jam. Kur përfundoj, përplasem mbi tokë dhe i rimarr bisedat, telefonatat, shof sendet rreth meje dhe i rendis ato ose i la pa i prekë si të pëlqyeshme ashtu sikurse janë.

Metafora mund të jetë dera nga e cila dal për ta kundrue botën ku jetoj nga pozita e një të jashtëmi, e atij që nuk e pranon pafuqinë e tij mbrenda saj dhe që, me pozicionin e ri të kundruesit, beson se e ka ndryshue sadopak statusin e tij të pëstuesit.

"Lule nate" i kam quejtë sepse ato kanë qenë diçka që u lidhën me mue dhe me gjendjen time përmes një biografie krejt të veçantë. Ato ishin diçka në vete dhe për vete, pra një përvojë që ngurronte me u ba në të gjithë procesin e vet të krijimit, prishmënisë, përcëptimit dhe vlerësimit, sepse disa nga kto gjymtyrë ishin të pamunduna. Fjala "lule" nuk tregon se ato ishin doemos të bukura, kurse fjala "natë" tregon se ato ishin detyrimisht të panjontuara. Kaq e vërtetë sa edhe mbas botimit ato mbetën prap "lule nate". Te ky togfjalësh fjala kyç nuk ishte emnori, por përcaktori. Në ato kohë e kishte pësue edhe sintaksa, ose po sforcorhe edhe mekanizmi sintaksor. Pra siç po shifet, shestimi i ktij titulli nuk ka qenë edhe aq fort mekanik dhe automatik, sa e foluna e jonë ose kombinimi i kuptimshëm i fjalëve.

Sa i përket "artit të madh të gjumit" që e kam çekë të parathanit e vëllimit "Lule nate", kuptimi nuk ka qenë manifestual siç mund të duket dhe nuk ka lidhje me André Breton-in dhe shkollën e tij. Ose ka dhe unë nuk e di. Por gjithësesi pritja më asht dukë art dhe gjumi më asht dukë humanizëm. Pëse humanizëm kur flejnë pothuëjse të gjitha kafshët? Kjo për një arsye kulturore. Te drama e F. Dürrenmatt-it, "Romuli i madh", personazhi kryesor i saj, një perandor romak, i fundit më duket, tue pa katastrofen e ardhjes së barbarëve dhe degjenerimin e perandorisë, në pamundësi me i ba derman, ka vendosë me e kalue me gjumë atë periudhë, si e si mos me u ba pjesë e llumit të dekadencës. Edhe unë pranova, si hominoid i detyruem nga epoka, adoptimin e letargos së kafshëpërlisë.

Arshi Pipa (1920-1997) e shkroi Librin e burgut në letra duhani nëpër burgjet komuniste të Shqipërisë. Intervista është marrë me shkurtime nga "Symbol".

I

INTERVISTA

Kjo është një copëz nga intervista për Paris Review, që dramaturgu, shkrimtari dhe aktori i njohur britanik dha shumë vite të shkuara. "Milosao" po e boton në nderim të Nobelist-it, por edhe në funksion të artit të tij të madh...

Harold Pinter: Bota është një vend i dhunshëm

NGA LAWRENCE M.BENSKY*

Pra... disa elementë të kompozimit nuk ka të ngjarë të përsëriten sërisht në vepër?

"Jo. Dua të shtoj se edhe nëse do ishte kështu, siç jeni duke thënë, elementë specifikë të veprës, kur përdoren shumë shpesh, do të kishin vlerë të madhe dhe një interes të madh për mua. Nga pikëpamja ime, ky jerm i përgjithshëm, gjendja mendore dhe kundërshtitë e lidhjeve në një dramë-megjithëse janë tmerresisht të shpërndara janë të njohura për mua. I di të gjithë gjërat që s'janë thënë dhe rrugën ku karakteret shkojnë tek njëri-tjetri apo edhe se çfarë duan të thonë, thjesht nga këqyrja e njëri-tjetrit. Është një dramë ("The Dëarf"), që u shkrua për tradhtinë dhe dyshimin. Thjesht ishte e mirë për mua që ta bëja".

Kur jeni duke punuar në një dramë, kush është sipas jush çelësi për një lidhje të mirë shkrimtar-regjisor?

"Ajo që është esenciale në këtë lidhje është shmangia e gjithë justifikimeve në mes të autorit dhe regjisorit. Është një çështje e besimit të dyanshem dhe e çiltërsisë. Nëse s'është kështu, atëherë vënia e një drame është thjesht humbje kohe".

Peter Hall, që ka drejtuar shumë nga dramat tuaja, thotë se ato lidhen me një formë verbale dhe ritëm strikt, madje kur shkruani "pauzë" do të thotë diçka krejt tjetër nga "qetësi" dhe tri pikat janë një element krejt ndryshe nga një pikë e plotë. A është kjo lloj ndjeshmërie për kështë lloj shkrimi si përgjegjëse për punën tuaj të përbashkët në ekip?

"Po, është pak a shumë kjo. I tregoj shumë kujdes këtyre pikave që i përmendet më sipër. Halls, njëherë p.sh. mbajti një pikë dhe një provë pauze për aktorët e "The Homecoming". Por, megjithëse tingëllonte tejtejt e qëllimshme, dukej se ajo ishte shumë mirë e menduar".

A i skiconi dramat përpara se t'i filloni t'i shkruani ato?

"Jo aspak. Unë nuk di se çfarë lloj karakteresh do kenë dramat e mia deri sa...ato...apo mirë, deri sa ato do jenë në letër. Apo derisa ato më tregojnë vetë se çfarë janë në gjendje të bëjnë. Unë, në një farë lloj mënyre, nuk konceptualizoj. Sapo mendoj që i kam gjetur çelësat, kam vazhduar duke i ndjekur drejtimet e tyre-sepse në të vërtetë, kjo është puna ime, që të ndjek çelësat".

Çfarë doni të thoni me çelësa? Mund të kujtoni p.sh. sa nga dramat e shkruara janë zhvilluar fillimisht në mendjen tuaj-apo ato janë thjesht rresht pas rreshti në progres të vazhdueshëm?

"Natyrshisht, s'mund të kujtoj saktësisht sesi një dramë e caktuar zhvillohet në mendjen time. Ajo

që mendoj se çfarë ndodh në këtë rast ka të bëjë me faktin që shkruaj në një gjendje të vërtetë nxitje edhe frustrimi. Unë vazhdoj të shkruaj atë që shikoj në letër në ballë meje-thjesht, fjali pas fjalie. Kjo nuk do të thotë se nuk kam herë pas here ndonjë si reshtje mbi ndonjë ide të përgjithshme apo dhe imazhin e asaj: që nëse s'do më sjell atë se çfarë ndodh menjëherë, do më japë ndjesinë e një ndodhie që më mban mua përtej saj. Kam gjetur një ide se çfarë mund të ndodhë dhe ngandonjëherë kam plotësisht të drejtë, por në disa raste, jam ndërë keq me atë që më ka ndodhur aktualisht. Ngandonjëherë shkoj për gjatë punës dhe e gjej veten duke shkruar "C. hyn", kur nuk e dija fare se ai do kishte qëllim të hynte; ai thjesht duhet të vinte në këtë moment, kjo është e gjitha".

Në "The Homecoming", Sam, një karakter që nuk ka qenë shumë aktiv për do kohë, papritmas qan dhe rrëzohet për disa minuta me rradhë aty nga fundi i dramës. A është ky një shembull i asaj që doni të na thoni? Duket si e papritur.

"Papritmas. Po, kjo mu duk pikërisht e qëlluar. Thjesht më erdhi. E dija, që ai kishte për të thënë diçka në një moment në këtë seksion dhe kjo ishte ajo që ndodhi, kjo ishte ajo që tha".

Mund që karakteret të zhvillohen kështu tej kontrollit tuaj, duke arritur edhe për ta ndryshuar idenë tuaj-edhe sikur kjo të jetë një ide e vagullit, rreth dramës?

"Unë i mbaj atëherë të shtrënguar litarët, kështu që ata nuk

mund të shkojnë shumë përtej".

E ndjeni se kur duhet të ulet perçja, apo e bëni punën tuaj të ndërgjegjshme në tekst drejt një aksh momenti, që ju gati e keni të vendosur në kokë?

"Është thjesht instinkt. Perdëten kur ritmi më duket i drejtë-kur aksioni të thërret tamam për një fund. Unë jam shumë i dhënë për linjën e perdevë dhe uljen e tyre në kohën e duhur".

A e ndjeni vetë kur dramat tuaja janë të strukturuar me sukses? Thjesht, a jeni i aftë të komunikoni për këtë instinkt me ritmin e dramës?

"Jo. Jo në të vërtetë. Dhe ky është edhe shqetësimi im kryesor: të gjej një strukturë të rregullit. Unë shkruaj gjithmonë tre variante, por që në fund duhet që t'i lë ato përfundimisht. Dhe, vjen një moment kur thua: Kjo ishte. Nuk mund të bëj asgjë më shumë. Të vetmet drama, që i gjej veçan afër një ekzistence strukturale dhe që më kënaqin janë "The Homecom-

ing", "The Birthday Party" dhe "Caretaker", të cilat kanë shumë shkrim. Dua të sheshoj gjëra, pra t'i eliminoj ato. Shumë fjalë më iritojnë tepër, por nuk mund t'i mbaj, duket se ato më dalin-nga jashtë gojës së miqve. Në të vërtetë nuk i shqyrtoj gjatë punës e mia, por e kam të qartë se shpesh në atë që shkruaj, apo të paktën me atë që shumë miq më kanë thënë: në disa pika personazhet e mia flasin jashtëzakonisht shumë".

Shumica e njerëzve do të binin dakord se fuqia në dramat tuaja shtrihet në atë që quhet aspekti verbal, modalitetet dhe forca e karakterit, që ju arrini e nxirrni nga personazhi. A i gjeni këto fjalë nga njerëzit, kur i keni dëgjuar duke folur-apo i përgjoni nga jeta?

"Nuk shpenzoj shumë kohë duke dëgjuar në të gjitha senset. Rastësisht, edhe mund të dëgjoj diçka, siç e bëjmë të gjithë, duke ecur. Por fjalët më vijnë vetë kur jam duke shkruar për karakteret, dhe aspak më përpara, si thoni Ju".

Pse mendoni se dialogjet në dramat tuaja janë kaq të gjetura?

"Nuk e di. Mendoj se kjo ndodh ngaqë njerëzit zbrapsen nga të gjitha gjërat, ku mund t'i shtrijnë duart krejt fare verbalisht-thjesht për t'i mbajtur ato jashtë rrezikut të njohjes dhe të qenurit të njohur".

Çfarë hapësirash në dramat e shkruara ju japin më shumë shqetësim?

"Janë atë që koklavitura në raport me atë që unë bëj saqë nuk mund të gjykoj momentalisht".

Pak vjet të shkuara, "Encounter" ka pasur një seri të tërë citimesh nga njerëz të ndryshëm në botën e artit rreth idesë për bashkimin e Britanisë në Tregun e Përbashkët Evropian. Deklarata juaj ishte më e shkurtra, që ishte bërë ndonjëherë: "Nuk kam ndonjë interes në çështjen në fjalë dhe madje as nuk e çaj kokën për çka ndodh". A e përmbledh kjo ndjenjen tuaj rreth politikës, apo çështjeve aktuale?

"Në të vërtetë, jo. Megjithatë, për atë që ndiej për sa i përket Tregut të Përbashkët-unë tamam them se nuk e çaj kokën asfare për Tregun e Përbashkët. Por, s'është edhe krejt e vërtetë që të them se, në një farë mënyre jam krejt indiferent për çështjet e ditës. Jam në një gjendje normale e qenies shumë konfuzë-i pasigurt, i irrituar dhe i zemëruar në reagim, por ngandonjëherë mbetem edhe indiferent. Në përgjithësi, përipiqem të arrij vetëm atë që mund të bëj dhe ta lë atë kështu si është. Nuk mendoj se kam arritur ndonjë lloj funksioni social të ndonjë vlere dhe politikisht nuk ka arsye për të qenë i përfshirë sepse çështjet janë më të gjithë kuptimet e thjeshta-të jesh politikan duhet të jesh i aftë të prezantosh një pikurë të thjeshtë edhe nëse nuk e shikon fare në këtë lloj mënyre".

A ka ndodhur ndonjëherë tek ju të shprehni opinionet politike përmes karaktereve tuaja?

"Jo. Kategorikisht politika më lodh, megjithëse unë e njoh që ata janë përgjegjës për këtë pjesë të madhe të vuajtjes në Botë. Unë dyshoj për gjendjet ideologjike të çdo lloji".

Por a nuk mendoni vallë se paraqitja e një lloj kërcënimi personal, që është prezantuar ndonjëherë në skenën tuaj, është shqetësimi më i njëjntë të madh, një sens politik, apo e gjitha kjo ka në të vërtetë një lloj lidhje?

"Nuk e ndiej veten të kërcënuar nga ana e ndonjë grupi politik apo aktiviteti në përgjithësi. Më pëlqen



të jetoj në Angli. Nuk e çaj fare kokën as për strukturat politike-sëpse ato nuk më alarmojnë, pasi ato shkaktojnë vujtje të një masë e madhe prej miliona njerëzish. Dua t'ju them se çfarë mendoj në të vërtetë për politikanët. Një natë kam parë disa politikanë në televizion, që po flasin për Vietnamin. Doja shumë që ta shpërtheja ekranin me një flakëdhëse dhe t'u digja sytë dhe qoqet, e pastaj t'u kërkoi sesi mund të ndërhej nga ky akses nga pikë-pamja politike".

A e keni përdorur ndonjëherë këtë zemërim në ndonjë dramë të orientuar politike?

"Jam rastësisht jashtë irritimit, megjithëse flitet për të shkruarët e dramës me një pikëpamje satirike. Bëra në të vërtetë, dikur, një dramë për të cilën asnjëri nuk di asgjë. Një dramë të plotë, të shkruar deri në fund, dhe që u shkrua pas "The Caretaker". Edhe atë, të mallkuarën, e kam shkruar në tre variante. E quajta "The Hothouse" dhe bënte fjalë rreth një institucioni në të cilin mbahehin pacientët; e gjitha që është prezantuar më pas fliste për një hierarki dhe për njerëzit që i drejtojnë institucionet: askushi nuk mund të di se çfarë ndodh me pacientët, apo se për çfarë ishin ata atje, apo thjesht se pse ishin ata. Ishte tejet satirike, por krejt e padobishme. Kurrë nuk fillova të pëlqej asnjë prej karaktereve; ata në përgjithësi dukeshin se nuk mund të jetonin tek e fundit. Kështu që hoqa dorë menjëherë nga drama. Karakteret ishin pastërtisht prej kartoni. Mendoj se flitet qëllimisht për një kohë të vetme dhe unë duke u përpjekur të realizoja një pikë, një pikë të veçantë, ju këta ishin njerëz të këqij -unë s'i pranoja dot fare. Dhe, kështu, ata edhe nuk mundën që të jetonin. Mos të harrojmë se në dramën e tjera të miat edhe për çdo karakter të vetëm, madje edhe për një bastard si Gooldebergu në "The Birthday Party", unë kujdesem deri në fund".

Ju shpesh flisni për karakteret tuaja si qenie të gjalla. A ngrihen ato pasi e keni shkruar dramën? Apo thjesht, kur jeni duke e shkruar atë?

"Të dyja".

Janë aq vërtetë sa edhe njerëzit që njihni?

"Jo, por ndryshe. Kisha një ëndërr të tmerrshme, pasi kam shkruar "The Caretaker", për të dy vëllezërit. Shtëpia ime u dogi në ëndërr dhe përpiqesha të gjeja se kush ishte fajtori. Isha i drejtuar nga të gjithë llojet e shtigjeve dhe kafeve dhe eventualisht mbërrita në një interior dhome diku dhe atje tamam ishin të dy vëllezërit e dramës. Unë u thashë: "Ju e dogët shtëpinë time". Ata thanë: "Mos u shqetëso shumë për të" dhe unë u thashë: "Kam vënë gjithçka aty. Ju nuk e kuptoni se çfarë ka ndodhur". Ndërsa ata më thanë: "Ke të drejtë, ne do ta kompensojmë atë për ty, do të kujdesemi komplet për ju", fliste vëllai i vogël dhe pas kësaj unë shkrova një çek për pesëdhjetë duhane. U dhashë atyre çekun për të marrë pesëdhjetë duhane!"

A keni pasur ndonjë interes të veçantë për psikologjinë?

"Jo".

Asnjëherë, kurrë? A keni pasur ndonjëherë qëllim në mendje për shkrimin e fjalimit kur vëllai i madh përshkruan shqetësimet e tij në një spital psikiatrik në fund të Aktit II tek the "Caretaker"?
"Disi. Kisha një si qëllim në sensin që... Aston papritur hapi gojën. Qëllimi im i vërtetë ishte ta lija atë të ikte duke folur, derisa të mbaronte dhe atëherë... të ulja perdet. Nuk kisha ndonjë mendje për të fiksuar aty boshtin e vepërës. Dhe e vetmja gjë që njerëzit kanë humbur është që nuk është e nevojshme të konkludosh për të gjitha ato që thotë Astoni për eksperimentet e tij në spitalin psikiatrik, si të vërteta".

**Përktheu Ben Andoni.
Marrë nga "Paris Review"**

P

POEZIA

NGA ROLAND GJOZA

ËSHTË NJË FYTYRË

është një fytyrë e mbetur në numra
nje trup
pesa buza jole
dyshi hunda
dhe me radhë lere trupi yt në një numër telefoni të gjatë

sa herë numrat shtyp
peklat e tua në duar
dhe një afsh me vjen nga larg

të zhvesh me një numër
nudo në ajrin vertikal
po asgjë s'është reale

të gjitha shpikjet janë sensuale

po telefonat të pafajshëm

PREJ KOHËSH KAM NUHATJEN E QENIT

prej kohësh kam nuhatjen e qenit
dhe në kopshtet e paçelur nuhat erën tënde
dhe në tymin dhe në pluhurin që ngrihet me fashe
të gjitha makinat e Nju Jorkut s'punojnë me benzine
po me aromën e trupit tënd virgjin
eh, ç'më gjeli me këtë nuhatje qeni
po kam dhe kapelen prej felti të modlianit
shoh në çdo dru të rrezuar prej erës
kofshet e tua të medha
dhe në kavakët e bardhë
kurmin tënd të lartë që ngjyhet me agim
s'mund t'i shoh dot gonxhet e paçelura të manjoles
se me trullusin gjinjtë e tu me thilka të pathithura
jam bërë si i marrë
në qoftë se natyra është një çmendinë
unë jam një pacient me pak

SONTE NUK DO TË ECI NË AVENJUNË E MODËS

sonte nuk do të eci në avenjunë e modës
po në ajër
në të gjithë gratacjelat qepet ditë e natë dhe filli delikat përsh
kohet nëpër gjilpërat elektrike
coherat rrinë në ajër
varur në kremastarë fustanet
ecin në ajër veshjet e vjeshtës
dhe kemishet në ajër
dhe kravatat lidhen në ajër
dhe fletet e vjeshtës në ajër janë duke ecur
dhe unë dua të shkoj në shlepi në ajër
duke ndjekur ritmin e gjilpërës që qep mbremjen
që qep fletet e vdekura në veshjet e stinës
që bien nga pemët
dhe ecin në pasarella
vetëm në Nju Jork nuk vdes vjeshta
po behet mode
në ajër eci
të qep dhe unë poezinë
në vend të gjilpërës elektrike
një fletë e vdekur që bie

KJO PRANVERË

kjo pranverë s'vjen si lymi i tulit
një budalla që bente të gajasej tërë qyteti
ketu në Amerikë
vjen me një vetmi të madhe
të çdo stacion autobuzi
japin këshilla për depresionin
ah, ta kisha atë tymin e tulit
t'ia vija nën sgetull pemet
t'i celnin në zgjyren e lekures
lule
t'ia jepje me atë palmën e gomarit
në Manhattan
t'i shante njujorkezët nga nëna!
po s'e kam
s'di ç'të bëj pa të

Autori i njohur sjell një cikël ku përmbledh të gjithë frymën e tij, ku pesimizmi ndërthuret me një lirizëm të hollë për qytetin më të zhurmshëm të botës...

jam gati të bëhem vetë lymi i tulit
po s'më të hunda!

EPSHI PO MË HA E PO MË GRIN

epshi po më ha e po më grin
pak shpirt, pak shpirt merr pjesë në këtë plojë të mishit
dy pranvera do të vijin shijet
mund të vijin dhe tre
s'dalin lulet
as hënat në ujë
bukurinë tënde s'ka shue e zburonur me shumë
t'i ben dhe pa to
pa ty ato s'kanë kuptim
prandaj zoti shpiku arlet
muzikën, pikturën dhe vargun
muzika doli nga zëri yt me flatra
ngjyrat e ardhangela të mishit
janë bojerat e vajit të kanavacës
vargu doli nga ajo thilka e kaftuar
nga pubisi i flakëruar prej zjarrit
pambarimisht digjen e fiken vargjet
prej orgazmes
kllithmë s'çartur
ohmajes e ahlnajes së shtrallit
në një det sperme buçimtare
i mjere poeti para pubisit tënd të flakëruar
të bie në gjunjë dhe të lulet
për gjinjtë e myshkëlluar
me pjergulla rrezuar
për kofshët mëshore që shkallërojnë rimat
përgjeronhet poeti dhe s'ngrihet
pa iu dhënë t'i gjer në frymen e fundit
dhe në djalli vargu, rrofte kurmi i gruas!
dhe pas frymës së fundit, ta dish
epshi do të më hajë e do të më grije si krimb
thërrime shkofsja në varr
epshi dhe balten ta grije dhe ta hajet!

ORA SHTATË E MBRËMJES

ora shtatë e mbremjes
unë shkruaj
karrocet mondana të nëntëqindës të çirkudit kolomb dhe aven-
ju e pestë
çojnë zonjat në opera metropolitane
mbushen restorantet dhe teatrot të avenju e shtatë
në hotelet e famshëm të americas avenju dhe rockefeller center
zonjat me kameleje mbushin dhomat e rezervuara
Nju Jorku i ngjan një titaniku në oqean
jo si tragjedi
po si farsë
ç'dua unë ketu, moj hënë?
po ti çdo mbi këto rrokaqet?
në Amerikë as një fustan s'te qepen
të lanë fukara
e kthej me fund dhe më duket se do të kem sukses
kur më del pija dua t'ia heq vetes
veg ti më qelëson
kujtim i largët
hipi tek ti si në një avion dhe shkoj
ora shtatë e mbremjes

PO E HUMBJA

po e humbja si qytetërimin e vjetër ballta dhe pluhuri
veç sytë i kishin mbetur përjashta
në një stinë të ndritshme
kur mjelma blu e Amerikës së Veriut bënte dashuri në drurë
me mjelmën e kuqe të amazonës
pra, ishte pranverë
po vec me një flatër
tjetren e kishë marrë t'i nën dhe
po humbje dhe sytë
dhe hëna me s'do të dilte neteve
fshetur qepallave të tua
dhe dielli
zjarrin do të humbte
prej syrit tënd që mbante ballancën
s'kish më epshe
qenë platurt dhe tufanet
dell me valë të vogla si buzë foshnjeje
ai sy që po e vajzëronte botën
kish kaq shumë poezi
sa vetë esenini ish ngjallur
me smoking dhe bastun në dorë shkante mespermes parisit

i dehur si maji kur kanë lulezuar dhe hithrat
ai syri yt ka mbetur ende pa e mbuluar krejt rrenojat
vetëm ai sy mëngjesi
ende pa dalë dielli
kur hëna është nisur për në mbremje

MBRËMJA SIKUR ERDHI ENKAS PËR TY

mbremja sikur erdhi enkas për ty
me një mjegull si penjuar dhomë që rreshqet mbi gjinj dhe bie
poshtë mbi gishtërinj
me yjet që shkasin një nga një si prej një gjerdani të keputur
dhe rreh mbytur një zemër kameleje
me një aromë të merme
ngjitesë
si prej sperme
forma kofshësh buisin prej fundesh dhe lart plaiten
me një angushti epshi
zgjaten në erresirë drurët si penise
me një fëshfërimë të mbytur
dhe një vetull vetelime që çahet
prej një shuplake ajri
pastaj peshijellim prej ndjesish që ndizen
dhe dallë të mëdha psherëtimash ndezin zjarre në hapësirë
me një ngjerc e ulërimë ere
shfaqet hëna si vaginë
ngulur mbi drurët si penise që rrasen thellë
krau krau kërcasin dritaret që përplasen prej korenteve
një qytet pranveror i shpartalluar prej orgazmës së mbremjes
dhe shtrëritë dalin nga shtëpitë
catllë shayhen
nga oxhaqet shungullimë e tymit të mishit nxin
fushqeta shpërthejnë prej ferkimt
një kllithmë me pupla përçillet
në buzë të agimit
si një qarje prej ngjyre drita e parë mbi ujëra bie

ME NATËN KAM PUNË

e lashë mëngjesin
dhe mesditën
me natën kam punë
s'ka njerëz
të gjithë flenë
fillikat i vetmuar endem nën një
anjë yll s'fitova në jetë
po yje të rreme sa të duash
thoshe atje lart me presin shpirtrat
unë pres të më dalin
flratat nën sgetull

do fluturoj?
kurrë s'fluturova në jetë
po si krimb u zvarrita dhe si krimb po e mbyll
në një rrokaqell në manhattan
në një rrugë të madhe
që i thinë fashion avenue

po s'jam i trishuar
as i zhgenjyer
sa frymë nuk lindën dot?
unë e pata këtë fat
të shoh më në fund amerikën
dhe steve jobs

jo
s'është pak
po vonë është për mua, tepër vonë
të ndërroj fjalën e bukur me dollarin
po duhet ndërruar
që të më heq kapelen
dhe të më nderojë
mister morgani

njerëzit flenë dhe unë i vetëm
pres të marr pasaportë nga nalta
dhe të nisem për andej
ndoshita udhës takoj Krishtin
unë ngjitem
ai zbritet

atje poshtë prap e pret ndeshkimi
populli si dele
që thirri dje Mesia
do ta kryqëzojë në shtyllë përsëri

P
PROZA

Një sprovë etydi e autorit, por që ka nevojë të trajtohet më maturisht ende...

Rryma e fshehtë

NGA FLORIAN ÇANGA

Retë e bardha sa ishin larguar nga plazhi i Shpellës në Lukovë. Dielli sërish me nxehtësinë e tij rriti temperaturat aq shumë sa nuk arrihej të qëndroje jashtë. E këtë nxehtësi nuk po e duroja dot dhe u be aq acaruese sa mendova te futem drejt në det. Une e kam qejf detin por nuk jam shumë i mire në not ndaj shpesh rri afer bregut për të qene i sigurte. Eshhte faji i një xhaxhai që për ta bere çunin e shkathet ma futi friken ndaj detit duke më hedhur nga një ure.



Uji ishte i ngrohte dhe mbi te gjitha pa dallje. Sipërfaqja ishte e qetë dhe në horizont përzihej me qiellin blu. N.g.s. do isha aviator do fluturoja ulët vetëm për të parë këtë qetësi uji. Bëra pak not dhe qëndrova në ujë sepse një rryme shume e lehte dhe pak e ftohte me kaloi afer pulpes se kembes. Ishte si një perkedhelje qe zgjati pak. Nuk lëvizta duke menduar qe një ngacmim i momentit. Sa here ngacmohemi në ditet e sotme por si vërejmë re. Leviza kembet neper uje kur prape e preka. Me preku shputen e kembes dhe filloi te zhdukej gradualisht perseri.

e gjate dhe për çudi po qëndroj. Ose me sakte une po e mbaj sepse asgjë në det nuk rri pa lëvizur: Fill-ova ta ndjej ngadale nepermjet kembes. Linjat e ujit te ftohte detin qarte. Rryma me linjat e saj elegante me ka përfshire tashme te dyja këmbët dhe me ciklle me ledhatoon. Shpesh vjen dhe iken por levizjet e mira jane konstante qe ajo mos te iki. Njeriu ben shume gjera per ta zoteruar dicka por shpesh pak per ta mbajtur. Ndosh- ta prandaj jane enderrat e cuditshme sepse nuk i zoterojme.

Sensacioni ishte shume i mire dhe mendova qe nuk është keq te kesh pak fresk ne ujë kaq te ngrohte. U përpoqa ta ndjek por nuk e përcaktoja ku ishte dhe s'dija si ta gjeja. Ndoshata mund ta prishja. Çdo gjë që vjen ose e njeh nëpërmjet detit është delikate. Shpesh njerëzit në plazhet e Dhërmiut dhe Jalës duken sikur lajnë mëkatet e qytetit ne det. Dhe unë me aq shume alkool qe kam pire 3 ditet po me ndodh.

Vendos të zhytem., ndoshata duke qene nen uje e kam me te lehte te shikoj dhe ndjek. Dhe rryma po bën te veten. Po me tërheq aq shume sa më mire te jem nen uje sesa mbi te..

tërheqje e çuditshme. Hap sytë dhe ç'te shoh. Shumë ngjyra/. Ngjyra pa fund. Një kaloidoskop i tere. Ngjyrat e ndezura të Goa Trance. Unë nuk pi drogera acide perse këto ngjyra. Deti është blu. Madje dhe shume kafshe ne det janë blu për të mos u dalluar kur fshihen dhe kur gjuajnë. Madje dhe vete deti është blu qe te mos tregojte historitë e tij. Po, perse unë shikoj keto ngjyra.

Nga levizja e ngjyrave kuptoj qe jam i rrethuar nga rryma. Linjat e saj gradualisht fillojnë e më rrethojne. Me siguri per te me hequr panikun. E cfare paniku une me kembe mbi shkembim menujor jam. Jane linja aq te bukura, /dhe aq te njetrajteshme. Te gjitha linjat jane perfekte me njera tjetren qe mos te ngjalle frike as panik Te gjitha japin një ndriçim nga levizja e tyre. Si meteori kur bie. A një qëndër me siguri që i jep driten ketyre linjave. E to s'mund të jenë kaq te pavarura. Duhet ta kenë shpirtin e tyre që i gjeneron. Ndeshmeria qe te krijon është si përkedhelje e lehte.

Zgjas dorën ta prek por kuptoj qe është larg. Kuptoj qe jam i rre-

thuar dhe nuk I arrij dot. Leviz dorën time dhe rryma valëzon lehte por pa ndryshuar forme. Kujdes më thotë, mos me ngacmo se dhe mund te iki. Por une s'dua te ike. Thjesht dua ta prek. Te futem brenda saj dhe ta shikoj se cfare ka pertej. Njeriu gjithmone kurioz është. Por nuk është thjesht kuriozitet. Dhe pse është larg meje rryma me ka rrethuar.

Befas ajo fillon te iki ne një moment. Linjat e saj fillojnë të zhduken gradualisht.. Jo, nuk duhet te ndodh, deti errësohet dhe nuk ka më drite. Eshhte një errësirë absurde brenda detit dhe jashtë është ditë. Si është e mundur kjo? Leviz neper uje dhe dal sipër. Përpiqem të notoj dhe me sy nën ujë kontrolloj por nuk shikoj gjë. Ruaj koordinatat e vendit ku isha dhe shikoj rrethe qark. Por s'ka sërish gjë.

Kthehem aty ku isha dhe pres. Patjetër që duhet të vijë s'ka kuptim. Pres dhe pres., te rrish shume në ujë nuk është mire por me mire por pres... Uji nuk është shume i ftohte dhe akoma

Erdhi përsëri. Zhytem me shpejtesi dhe jam perseri brenda saj. Nje drite ne thellesi si gur diamanti , ngjyre ari gjeneron ngjyrat e saj. Linjat jane me te shndritshme. Madje disa kane xixa. Përpiqim ti prek sa shume dua ti prek por me thojne vetem per pak mund te me prekesh sepse me shume nuk mundem. Ato kane ndryshuar drejtim kalojne permes trupit tim. Si shite e mundur kjo.. si mundet qe trupin tim ajo ta shnderroje ne transparent. Hyn dhe del. Kjo me shkakton mungesa ne frymemarrje.... prit çp bej?!

Po marr fryme nen uje. Vetem brenda saj ndodh kjo?! Si eshte e mundur? Shikoj driten dhe dua te shikoj drejt saj por nuk mundem.

Ajo me ben te ndihem shume i emocionuar dhe sa me shume afrohem aq me shume me krijohet një gropë ne gjoks. Trupi im nuk eshte me materia e dikurshme. E gjithë rryma fillon futet brenda meje. Nuk arrij dot te kuptoj me gje, por përpiqem te kapem ne linjat e saj .Ajo me shmanget por une dua ta kap. E shikoj qe ka frike. rryma ka frikerat dhe mendimin e saj. Qe ajo nuk ta tregon me fjalë por me lëvizje. Eshhte si një balerine arabe qe te lëviz trupin e saj por ti se prek dot.

Por instiktet e mija jane me te forta. Arrij te shikoj drejt diamantit qe leshon, e prek dhe ai e ul driten , ndoshata frikesohet nga une., ndoshata nga situata ndoshata nga gjerat e tjera qe ka ky diamant. Gishtat e mij shetisin ne te gjithë formen e tij . Kudo ku une prek drita theksohet. Ndoshata kjo eshte shenje e mire. Po i pelqen prekja ime. Ky diamant, kjo rryme , genka kaq e forte por dhe kaq e lëmuar. Linjat e ngjyrave janë rreth nesh. E gjithë energjia jone shkembet. Diamanti me ka hyre ne zemer, ne mushkri, ne mendje. Por nuk e degoja. Nuk degoj gje kur jam me te. Vetëm qetësia e tij me një sfond uji.

Nje zbratzi u mbush ne momentin qe unë preka diamantin ishte një moment qe zgjati pa fundesisht pa ore. E gjithë rryma me mbështolli duke me mbajtur brenda, sikur thoshte (rri ketu brenda meje . e gjithë rryma buzëqeshte, me përqafohte , dhe arrija te imagjinoja zërin e saj. Çdo gjë dhe frymemarrja ime u stabilizua, prej saj. Rryma më puthte, më përqafohte dhe me shikonte me sy të ëmbël. Çdo gjë brenda linjavte te saj kishte ndeshmëri. Atëherë unë i babezitja brenda levizja brenda saj . Lëvizjet e mia filluan të shitonin dritën e diamantit duke ndryshuar të gjithë vorbullën , linja gjithmone e më të holla uji si flokë filluan te lëviznin, drita gjeneronte grimca dhe fluide. E kuptova qe asaj i pëlqente dhe kjo gjë më bënte te ta prekja me shume të lëvizja te gjithë trupin tim. Rryma dhe diamanti shkëlqenin gjithmonë dhe me shume , çdo gjë brenda meje lëvizte dhe nxirrte tinguj të egër. Frymemarrja shpeshuta aq shum, e sa s'po merrja dot me fryme mushkërite nuk po lëviznin por une jetoja dhe isha ne një ndjesi perfekte drite te bardhe...

Rryma me hoqi çdo gjë qe kisha, çdo ngarkese, çdo mendim. Ajo me tregoi qe ekzistonte vetëm ajo dhe këtu në këtë moment je me mua. Dhe une e ndoqa. Per te me ruajtur ajo me nxori ne breg duke me lënë aty me kujtimin e saj. Por me ia imazhin e saj në mendje dhe tronditjen e une kam prer asaj dite. Mungesën në mushkëri një gropë që vetëm ajo e mbush. Që më bën të rrij pranë saj, duke pritur për momentin ku te jem prape me të. Njerëzit ishin rralluar ne plazh, e dija qe ajo ishte ne det afer, ose ,te pakten do kalonte përsëri aty. . e vetmja gjë me vlere qe kisha me vete ishte një libër. Afer çadrës ishte një kioske e vogel ku shitej çdo gjë per plazh. Gruaja përpiqej që ti kënaqte të gjithë klientët duke qene sa me disponibel.

I afrohem dhe e marr me vete. Zonje ju lutem a mund t'ju le një liber per një person, qe, t'ja jepni. Ajo mund te vije pak me vone por do vije. Ju lutem jepjani.

Ajo u emocionua shume. Gjate plazhit shiteset shesin ushqime dhe objekte plazhi. Prezenca e një libri është dicka e rrallë për to. Si e ka emrin qa ta shkruaj për ta mbajtur mend. - me tha e një buzëqeshje e lehtë i kaloi në fytyrë.

E marr me vete duke i thënë: Nuk ka rëndësi. Ajo e di. Thjesht ruaje dhe jepja kur të ta kërkojë.

Dhe qe nga ajo dite ajo pjese e shpirtit tim ka ngelur ne Lukove , afer saj.

Dhërmi 30 korrik 2018

QYTETI I DHURATAVE

NGA SOKRAT PASKALI

I. Qyteti është një medaljon në qafën e qiejve Varur ne ujra qe rrjedhin Krijuar nga jermi i lutjeve te praruara me drite-ylli Te zoti i njeriut Qyteti i ngjan me etazherin ne dhomen e ndenesj mbushur me dhurata bere gjithë klas dy te munguara nxijne e ndrjine penda e babalt dhe ora e kurdisur e nenes njera drita e diellit ijetra hojet e henes sa do ti doja ato te dyja aty penda -si piramida varr me ngjan e mbushur me libra cep me cep çbiblioteke per djep ora- kambanë e katedrales qe celebron kur eshte heret a eshte vonë

II. një e carë ne qiell rrjedh mes permes rreke Pa peshq te kuq me nge Gjallesa te padukshme fshihen Ne dy ane betoni Si ushtrime aluvioni Rrotull xixelonja duken ne maj Mbi pasqyrat e dhuratave gjithë admirim ç'nur Sheqelesuar nga e panjohura qe te djeshmen u djej Dhe te ardhmen u ngjin O zot sa i ri është ky qytet

Gulçi si rrekeja nga e cara e qiellit pa ngut del ne çdo fyt Kur kapërcehet kuplumi i ujrave qe rrjedhin Eshhte poezi Jermi galarte sjell kur lutja prarohet Atehere ne medaljon shenje u la Varur neper ujra ne qafen e zollit te njeriut Qyteti i kanë harruar kuptimin e emrit Dhe ai është i tronditur nga amnezia Për flokesh kafen si shemrat etimologjite Xhindoset xhinsi nga xhindet Pastaj zbutet në polis për dite Enigma mekon mendeshen Ujerrat rrekeja e situr nga e cara e qiellit pa jerm rrjedh e rrjedh sërish dhe kulterbon psene

III. qyteti është medaljon në qafën e zollit Ne dehemi nga shkelqimi i arte i yjeve Banoret peme te sapombjella levizin me ngut Mbledhur i kane rrenjet ne bark Shija shisqat Pershembulli e shijshme - e hijshme pershembulli - e robrit dhe e zollit pershembulli ah oh - oh ah ahili pershembulli ah-ih! Një vazje e bukur neper shi nderkaq Ecen ne bulevard si perendeshe e panjohur me laka te larta si kullat e reja zhurmon çadra qe mban mbi koke dy tela te keputur ka hidheni çadren laguni neper shi u them syve te mi

qyteti oh sa i ri kurse une aq i vjeter si luljet medaljon ne qafen e zollit ne jermi procesionin e vjeter e percjell sikur e vjell dhe procesionin e ri e pres ne agoni

IV. ne ujrart qe rrjedhin statujat jane peshq te kuq Ato dalin nga njera-tjetra si matrisoshka Asnjera s'me tërheq qe li them dicka per emrin enigma rrjedhen e rreme mendeshë kulterbimi keto statuja per qytetin asgje s'dine jermi shperndahet sakaq dhuratat fillojne te bien nji nga nji ka dhurata qe bien e shuhen si qellim i jermi ka te tjera qe vijne nga te kater anet e ekstremit gjuhe te huaja mermeriten pshereliten pseudolavdi ky qytet nuk ka pasur as mure e as portë po neper rruge kane zhurmar gjithmone eskortat

V. me pendën e time ti dhe orën e nenes ne dore Para etazherit shkundur nga termeli mengjesin pres Rrekeja nderkaq dhe lumi i njerzese rrjedh pa zhurme Si shkume Zoli lexon lutjet e reja me shkronjat qe fshkellet- jne

Ujrat dhe jermi gerrryejne enigmen e vjeter te emit Ne medaljonin e ri Qyteti është një medaljon në qafën e qiejve Varur ne ujra qe rrjedhin Krijuar nga jermi i lutjeve te praruara nga zoli i qiejve Qyteti im nuk ben perjashim

VI. ka qytete te famshem qe lidhen me një emer - një jermi s'zi historia e Efesit me Heraklitin a ju kullohet ky e mallkoi se Efesi kur votoi me te mirin me sikter deboi por bekimi a mallkimi i një jermi nuk ze se eshte vetem një lutje dhe lutja duhet te prarohet ujrart rrjedhin për ta mbajtur ne qafen e zollit medaljonin kur shihni aty një si zjarr po digjen në tufen e druve tabute kur shihni dicka qe nuk e kuptoni është tempulli dhe fytyra e praruar e yllit ne jerm ka dicka per te thene qe duhet te degjohet kur shihni një shpirt qe u skalit e ka bere leatit biblioteke katedrajla poezia e zhduk ale qe gabimisht e bukur u duk

Tiranë 7 korrik 2018

Opinion i Ditës

Kryemodel i sjelljes politike

Nga Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

...e botës vijon vitin e 13 të kancelarisë së saj. Madje, ajo tashmë ka hyrë në historinë e lidërshipt të suksesshëm botëror: Ia ka kaluar dhe Thatcherit për nga jetëgjatësia si shefe qeverie dhe pritet të thyejë rekordin e paraardhësit të saj legjendar Helmut Kohl.

Krahas themeluesit të Gjermanisë moderne, Konrad Adenauer dhe "Babait" të Gjermanisë dhe Evropës së ribashkuar Helmut Kohl, Merkel është liderja më jetëgjatë e CDU-së, Partisë Kristian Demokratike Gjermane, me 19 vjet në krye të saj.

E kjo jo vetëm nga ana sasiore, por edhe cilësore; sidomos lidhur me lidërshiptin e guximshëm që ka treguar në kapërcimin e 10 krizave serioze ndërkombëtare me emra drithërues bankare/financiare, falimenti grek dhe italian, azili, terrorizmi ndërkombëtar etj.

Kur filloi karrierën politike më 1990 si ministre Mjedisë, vështirë që Merkel ta dinte se do të bëhej kancelare dhe mbrojtëse madhore e Evropës, deri sa në zgjedhjet e parakohshme në shtator 2005 nxorri jashtë loje kancelarin karizmatik Gerhard Schröder. Me vonë Merkel mposhti në "fairplay" politik emra të tjerë tingëllyes socialdemokratë - Presidentin e tanishëm Walter Frank Steinmeier, pastaj Peer Steinbrück dhe vitin e kaluar ish-presidentin e Parlamentit Evropian, Martin Schulz. Por edhe "burra" të tjerë politikë të vetë CDU-së, ku politikanet gra filluan të zënë vend shumë më të madh se më parë, kur "numëroreshin me gishta".

Po ku qëndron sekretin i forcës së këtij fenomeni tashmë emblematik dhe cilat janë tiparet e saj dalluese politike? Kur për hir të së vërtetës, Merkel nuk e ka oratorinë, vizionin dhe karizmin epike të paraardhësve të vet? Aq më tepër që 28 vite më parë ajo nuk e njihje politikën dhe vinte nga pjesa lindore në një parti tipike të ashpër "burrash" si CDU-ja e famshme.

Në analizat dhe studimet e deritanishme, këto "sekrete" shpjegohen me shumë cilësi të saj, ku qysh në fillim spikat sjellja politike, që të Merkel është krejt e veçantë.

Në fakt, kjo sjellje politike shkon shumë më thellë dhe më larg se manierat e jashtme, look-u, veshja dhe aksesoret, kortezia dhe rigoroziteti ndaj kodeve etike dhe protokollare. Kjo sjellje nuk kufizohet vetëm në raste të tilla të spikatura si të nesërmen e largimit të liberalëve dhe socialdemokratëve nga bisedimet për krijimin e koalicionit të ri, sapo hyri në Bundestag, Merkeli shkoi të lideret e tyre në sallë dhe i përshëndeti ngrohtësisht, natyrisht dhe me keqardhjen e rastit, këtë të fundit kryesisht me "gjuhën e trupit". As dhe vetëm vlerësimin dhe nderimin e saj të vazhdueshëm e jo thjesht ceremonial për politikanët kundërshtarë të



tanishëm dhe ata paraardhës.

Sjellja politike "Merkel" buron mbi të gjitha nga integriteti i saj absolut politik dhe qytetar. Në 30 vite të lidërshiptit të saj politik, jo vetëm nuk ka asnjë rast të vetëm skandalesh dhe aferash, por as aludime dhe dyshimet më të vogla për raste korrupsioni, shpërdorimi të postit e të tjera si këto.

Kjo sjellje politike mbështetet mbi të gjitha në frymën dhe vokacionin e theksuar evropian të Merkel, si busull e përhershme politike; në tolerancën, kompromisin, mirëkuptimin, besimin dhe zgjedhjen me durim të problemeve.

Ashtu si pohojnë vëzhgues të ndryshëm politikë, profesionist si fizikantë ka ndikuar të Merkel për të mbrojtur karakterin dhe personalitetin e saj me disiplinën, saktësinë, durimin, gjakftohtësinë dhe qetësinë që të jep kjo shkencë. Gjithashtu, në debutimin e saj politik, Merkel e kuptoi shpejt se ligjërimi publik, polemikat dhe debatet e forta nuk ishin siç thuhet në Gjermani "elementi" apo pika e fortë e saj.

Me gjithë fitoret e shumta politike dhe zgjedhore, Merkel nuk e njeh triumfalizmin politik, arrogancën, mendjemadhësinë apo maninë për t'u dukur e për të

pranuar e lozhe. Ajo i ka zëvendësuar ato me urtësinë, përmabajtjen, mençurinë, finesën dhe modestinë politike. Kjo shpjegon suksesin e saj në drejtimin e koalicionit qeveritar për një mandat me liberalët e FDP-së dhe për dy mandate radhazi me kundërshtarët tradicionalë socialdemokratë, me të cilët tani qeveris për herë të tretë.

Si përfaqësuese e një shkolle të re politike, Merkel dallohet qartazi nga gjuha dhe fjalori tejet i kujdesshëm, rrjedhojë e një logjike racionale, pozitiviteti, etike, respekti dhe bashkëpunimi me aleatët dhe kundërshtarët politikë.

Fjalori i saj i thjeshtë politik është përherë i përmbytur, i zgjedhur me kujdes, pa epitete, insinuatë, ironi e ca më pak sarkazëm, pa lëndime dhe sulme politike e ca më pak personale ndaj askujt, ca më pak ndaj kundërshtarit politik, gjerman apo të huaj dhe kur ata nuk kanë të drejtë morale dhe sado të "krisur e të këqij" qofshin; kërkë në jetën e saj të gjatë politike dhe nuk gjen qoftë edhe një rast të vetëm, sado të vogël të kësaj natyre!

Këtë cilësi, Merkel e ka shpallur qartë kudo dhe kurdoherë, në takime me njerëz të thjeshtë e

hallexhinj, me liderë botërorë në takime dy dhe shumëpalëshe, "në ditë me diell, por dhe me shi".

Ndaj, në intervistën e saj televizive në prag të pushimeve verore më 20 korrik, Merkel u shpreh kundër "erozionit" të gjuhës, e cila shpreh mendimin dhe kësajsoj shkohet drejt dështimit ose veprimt efikas; sipas saj, është ky i fundit që duhet të "sundojë" dhe jo gjuha sulmuese.

Kjo u pa qartë muajin e kaluar gjatë situatës absurde kaotike që krijoi "simotra" bavareze e CSU-së dhe lideri i saj, ministri i Brendshëm Federal, Horst Seehofer, me mesazhe populiste dhe ultimatumet të papara në politikën gjermane, por Merkel lu përgjigj vetëm me pohime pozitive dhe kryesisht me demarshet dhe hapa politikë/diplomatike. Brenda një jave ajo organizoi dy samite të BE-së, takoi homologët e saj kryesorë deri të kompromisi shpëtimtar lidhur me krizën e azilit, për të cilën kemi shkruar më parë dhe doli politikisht e fituar.

Ndërsa javën e kaluar; në kulmin e polemikave të ashpër politike dhe mediatake pas dorëheqjes së tij nga Kombëtarja gjermane, Merkel i doli hapur në mbrojtje Mesut Zil, kampionit të botës, superstarit gjerman me origjinë

turke; duke e vlerësuar atë si shembull të integritit të suksesshëm dhe duke respektuar vendimin e tij. Kancelarja edhe njëherë "uli ndjeshëm gjakrat" si në Gjermani, ashtu edhe në Turqi.

Këtë sjellje politike Merkel e rrezaton edhe gjatë interpelancave në Bundestagun gjerman, dëgjon e qetë kritika dhe sulme të ashpër, i shoqëron ato herëherës edhe me një buzëqeshje të lehtë, por pa asnjë ndërhyrje; vetëm në fund të interpelancës, pa përmendur emrin e folësit, por vetëm temën apo kritikën përkatëse, ajo jep përgjigjet e veta me shpjegimet e rastit. Pa përdorur asnjëherë fraza mohuese apo përcmuese ndaj askujt, por me finesë, qetësi dhe elegancë pohon vizionet dhe alternativat e saj të ndryshme ose të kundërta.

Këtë modesti, thjeshtësi, natyrshmëri dhe përulësi Merkel e shfaq edhe me median, edhe shtypin në intervistat dhe bisedat me ta, larg megalomanisë, gjuhës së drunjtë, arrogancës dhe zhargoneve të pa-pranueshme ndaj medias, madje edhe kur kjo e fundit "ta bën borxh". Po të mos e njohësh në daljet gjithsesi tejet të kursyera televizive dhe mediatake, me vështirësi e dallon se përballë gazetarit është kancelarja emblematike e shtetit më të fuqishëm evropian.

Kancelaria e saj e suksesshme 13-vjeçare, bashkë me, pse jo, dritëdhjetë e veta dhe erozionin zgjedhor tregon se shumica e elektoratit gjerman ka ende nevojë për një lidere të tillë, jo të zhurmshme, me bujë dhe megalomane, jo të batutave dhe e spektakleve boshe mediatake, por "me këmbë në tokë".

Duke parë këtë dhe shumë cilësi të tjera rrezatuese të lidërshiptit Merkel, shumë ekspertë dhe analistë të huaj tani pohojnë se nuk është ndonjë çudi që "Nëna e Gjermanisë", siç e konsiderojnë, një ditë jo të largët të bëhet dhe Nëna Politike e Evropës së re.

Ndaj, sjellja politike "Merkel" mbetet alternativë bindëse në realitetet e sotme sfiduese gjermane dhe ndërkombëtare dhe pengesë madhore për forcat populiste dhe ekstremiste në Evropë dhe më gjërë.

Së fundi, prej kësaj sjelljeje politike mund të mësojnë shumë edhe politikanët tanë, që pa mohuar shembujt dhe rastet pozitive kanë jo pak deficite në këtë fushë. Për më tepër, të mësojnë nga kjo sjellje politike nuk kërkon kushë, kritere, rregulla, projekte, fonde, negociata, por vetëm predispozicion, frymë dhe përgjegjësi politike/ qytetare ndaj publikut. Për më tepër, kur kjo sjellje politike është e rëndësishme për Gjermaninë, ajo është një "Muss", pra domosdoshmëri edhe për politikanët tanë të çdo niveli.

Dje në "Europa e lirë"

Financimi nga organizata të dyshimta ka prodhuar imamë radikalë

Nga Taulant Qenaj

(vijon nga faqja 1)

...dhe më ekstreme në Kosovë. Importimi i ideologjive apo rrymave më ekstreme fetare në Kosovë, sipas teologëve që kanë studiuar në këto vende shumë vite më parë, ka ndodhur për shkak të financimit të bursave nga organizata të dyshimta. Ata thonë se financimi nga këto organizata ka detyruar shumë të rinj kosovarë që kanë studiuar në këto vende që të ndjekin rrugë të gabuara dhe të largohen nga islami tradicional që ka qenë në Kosovë. Profesori në Fakultetin e Shkencave Islame në Prishtinë, Musa Vila, i cili ka kryer studimet në Medinë të Arabisë para viteve të '90 tha për Radion Evropa e Lirë se shumë prej donatorëve që financojnë këto bursa, u takojnë rrymave ekstreme. "Varet se me kë kontaktujmë, me çfarë shoqatash dhe me çfarë njerëzish. Kemi edhe sot të vijës ekstreme mjaft njerëz që ua kushtëzojnë bursën (imamëve të rinj), gjithçka ua kushtëzojnë për të qenë në këtë vijë. Për fat të keq, shumica e donatorëve të bursave janë të vijës ekstreme", thotë Vila.

I të njëjtit mendim është edhe imami Bekim Jashari nga Podujeva, i cili ka kryer studimet në Jordani. Imami, i cili për një kohë të gjatë ka qenë edhe kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në këtë komunë, thotë për Radion Evropa e Lirë se financimi i bursave është shkaku kryesor i radikalizmit të imamëve të rinj, që janë shkolluar në botën islame. "Gjeneratat para luftës së fundit të Kosovës, që kemi studiuar jashtë vendit, shumica dërmuese që kemi studiuar në vendet arabe, financimi ynë ka qenë nga familja. Po marr vetëm këtë element, se ka edhe të tjera. Në periudhën e pasluftës nuk e di që ka shkuar dikush, mund të jenë raste të pakta, që janë financuar nga familjet e tyre. Por çfarë rëndësie ka kjo? Ka rëndësi, sepse financimi nga familja të jep mundësi në një masë shumë të madhe që të ndërtohet personalitetin tënd të pavarur", thotë imami Jashari. Profesori Musa Vila thotë se edhe në kohën kur ai ishte student, kishte pasur rrugë të errëta apo qasje më ekstreme për islam, por që nuk janë përqafuar nga studentët e asaj kohe. "Edhe ne kemi qenë në Medinë, i kemi parë këto gjëra, por nuk kemi dashur të futemi në ato ujëra të turbullta dhe e kemi ditur që nuk është në interesin e vendit tonë, por as nuk



është në interesin e përgjithshëm që të bartim ide ekstreme edhe ide të cilat nuk përpunohen me islamit tradicional që e kemi ne, por që nuk përpunohen as me rrethanat e as me traditën tonë shqiptare", thotë Vila. Ndërkaq, kryeimami i Podujevës, Bekim Jashari, thotë për Radion Evropa e Lirë, se Jordania dallon shumë prej vendeve tjera dhe shkollave tjera islame. Ai thotë se universiteti ku ai ka studiuar nuk ka

qenë shumë i përqendruar që ta bëjë një kuadro njohës të fesë klasike, por ka dashur që t'i japë njohuri më të gjera. "Përderisa vendet tjera arabe që e kanë pasur një sistem krejtësisht ndryshe, Jordania nuk e ka pasur këtë. Sistemi arsimor dhe plan-programi arsimor në Universitetin e Jordanisë dhe në universitetet e tjera, po flas për atë kohë, nuk ka qenë nxitës i urretjes, përçarjes, sektarizmit, fraksioneve", thotë Jashari. Pas luftës së

fundit, shumë imamë të rinj kryen studimet në vende të ndryshme arabe. Disa prej këtyre imamëve edhe janë arrestuar për nxitjen e të rinjve për të shkuar në luftërat e huaja, në Siri dhe Irak. Në këto luftëra në Siri dhe Irak kanë shkuar për të luftuar mbi 300 persona nga Kosova, duke përkrahur grupin militant Shteti Islamik. Mbi 70 kosovarë janë vrarë atje dhe shumë të tjerë mbesin ende në Lindje të Mesme.

HOROSKOPI

DASHI

Frika që do ndjeni sot do t'ju demoralizojë. Mendoni pozitivisht dhe shihni anën e mirë të gjërave. Sharmi dhe personaliteti juaj do t'ju ndihmojnë të bëni miq të rinj. Sot do të jetë dita juaj me fat sa u përket romancave. Ka gjasa që të bëni disa plane në moment të fundit.

DEMI

Disa plane për udhëtime mund të duhet të anulohen për shkak të disa zhvillimeve të papritura. Do të shqetësoheni për pasojat, por mos e humbni energjinë. Ajo do të zhvillohet në një ditë tjetër më optimale.

BINJAKET

Sot do të ndiheni i vetmuar dhe i mbingarkuar. Kjo do të theksojë nevojën për të pasur pranë vetes partnerin tuaj. Por përgjegjësitë në punë nuk do t'ju lejojnë që ta përbushni këtë dëshirë.

GAFORJA

Sot do të përballeni me disa shqetësime familjare. Ju dhe anëtarët e tjerë të familjes të hasni në ndonjë provokim. Mos u shqetësoni. Në fund të ditës të gjithë do t'i shohin ngjarjet në një perspektivë pozitive.

LUANI

Sot keni nevojë vetëm për qetësi dhe aspak për praninë e miqve apo telefonatave të pafund. Sigurohuni që të gjithë ta dinë se çfarë prisni, në mënyrë që të mos ju bezdisin. Përpikuni të menaxhoni kohën tuaj.

VRIGJERESHA

Një vonesë e përkohshme në marrjen e disa fondeve të pritshme mund t'ju detyrojë të shtyni një blerje shumë të nevojshme. Mos e humbisni qetësinë për këtë, vonesa mund të ndodhë për mirë në këtë rast.

PESHORJA

Jeni veçanërisht të ndjeshëm sot dhe aspak tolerues ndaj kritikave. Përpikuni të mbanin nën kontroll ndjenjat dhe gjithashtu gjuhën. Çdo problem i sotëm për të lindurit në shenjë tuaj është kalimtar.

AKREPI

Nëse keni kaluar ndonjë problem shëndetësor kohë e fundit është e këshillueshme që ta mbanin atë nën kontroll. Disa vizita mjekësore do të jenë të mira për t'ju sjellë edhe shpirtërore.

SHIGJETARI

Pavarësisht nga disa hapa të mëdha që keni hedhur gjatë muajve të fundit, një rënie mund t'ju karakterizojë nëse nisni të dyshoni tek aftësitë tuaja. Një bllokim i përkohshëm ka ndodhur, por duhet ta kaloni sa më parë atë.

BRICJAPI

Po prisni të dëgjoni disa lajme të mira. Çështjet e rëndësishme të karrierës mund të përfshihen në këto lajme. A duhet patjetër që të uleni dhe të prisni? Ndoshka një telefonatë nga ana juaj është e këshillueshme.


UJORI

Kjo nuk është një ditë e mirë për të udhëtuar. Nëse e keni të detyrueshme, atëherë përdorni rrugët tokësore duke shmangur fluturimet, pasi mund të hasni në disa vonesa që do t'ju krijonin shumë stres.

PESHQIT

Një mik apo koleg i përfshirë në një sipërmarrje mund të ketë nevojë për ndihmën tuaj. Përpikuni të bëni më të mirën për ta ndihmuar. Do të ndiheni mjaft mirë për kontributin që mund të jepni.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Miller e Verdi-t.
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Derain.
11. Kishte 100 Teba.
12. Është vija e portës
13. Në fund te rritjes.
14. Drejtori Lokale Përmet.
15. Inicialet e Seagal.
16. King Cole i muzikes.
17. Ishite shpendi simbol i Jezu Krishtit.
21. Artikulli spanjoll.
23. Janë fjalëpakë.
25. Fillojnë titrat.
26. Është i mërzitshmi.
27. Ashtu si jeton heremit.
29. U kompozua nga Ravel.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Një kitarë indiane.

33. Janë edhe ato të sigurimit.
35. Është e harlisur në xhungël.
37. Mbyllin fushatat.
38. Kështu thirrej Eisenhower.
40. Ai dhe ajo.
41. Fillojnë vallen.
42. Inicialet e Delon.
44. Kalohet në gjumë.
45. Martini që që këngëtare
46. Një thirrje me emra.

VERTIKAL

1. U quajt qyteti atomik.
2. Qyteti i Abrahamit.
3. Italia në tabela.
4. Sapo fillojnë.
5. Nemo ai i Nautilus.
6. Janë në botë
7. Një tabu islamike
8. I famshmi Pacino.
10. Janë si falimentime
11. Ngjyhet një në tavolocë.
12. Timo i Mato Grudës.
14. Janë borxhlinj.
17. E përditshnja që ke në dorë.
18. Carson i fumetti-t.
19. U shkrua nga Sartre.
20. Në fund të vitit.
22. Është lloj poezie.
24. Janë shtëpi... qeni.
25. Janë kapriçiot.
27. Verifikuar pjesërisht.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Është sekrete në derë.
34. Kodi i celularit.
36. Daja i Amerikës.
39. Kaluar në krye.
43. Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Atkinson, alias Mister Bean.
5. Ishite dyqanxhi i dikurshëm.
10. Ferrara regjisori.
12. Kalohet në gjumë.
14. Të parat në sondazh.
15. Është nofka.
16. Një treshe në skenë.
19. Nuk i tregohen babait.
21. Gjysmë tatimi.
23. Berenger aktor.
24. Në mes të një forme.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë nazet
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Është zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Entë Civile Europiane.

VERTIKAL


40. Janë galeri në hekurudhë.
41. Ramazotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Është pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë tatimi
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot ngas Tantai.
51. Janë brinjët në skuadër.
52. Qendër fitimi




VERTIKAL

1. Është edhe ajo emërore.
2. Është edhe ai mbretëror.
3. Të parat në Wellington
4. Një vegël
6. Është vendi aderues
7. Është emirat.
8. Mbyllin portat.
9. Pak latinisht.
11. Janë zjarrvënës.
13. Qyteti i perjetshëm.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkroi Këngëtarja tullce.
20. Inicialet e Moravia-s.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë
35. Është logjarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilace.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Fillojnë tjetrën.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

M A K U T E R I T I M
A G A R R E N D M I K E
L I T A R E T E S O
E M I L L E A P E L I M I
E L E D E P O Z I T A T
A T E K A P A N O N E T
L E S K A N A R I N E A M
E S S E N D A M E A N A
G I P A M I T E M E R
K O R R I K U I K O L L A
U N A Z A R E N D O R E
M I R A N D A B I S H T I
I R A A R M A D H I D
T O A P A R A T E T A E
I N R I M O T E T U M A
I R D A M A R E T I L
M K A B I N E T E R A R
F U R T E K E T E N I K E
P E R S E T I N T I M I
L A O I G O L A I L A
I H R T P E T E R I K
V O L E E L E N D E E

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	2		5	9	3			
	1	3	8		6			
9			3					
		5	7			8		
5	4		2	3				
2	6							
	8		4	7	5			
7	1							

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	9	3	8	1	6	5	2	7
5	6	1	7	3	2	4	8	9
7	8	2	4	9	5	6	1	3
2	4	7	3	6	8	9	5	1
8	1	6	9	5	4	7	3	2
9	3	5	1	2	7	8	4	6
3	2	8	5	7	9	1	6	4
1	5	9	6	4	3	2	7	8
6	7	4	2	8	1	3	9	5

Argëtim filozofik

- E mira ekziston, e keqja duhet të krijohet.
- Liria nuk do të thotë se ju keni kontroll absolut mbi jetën tuaj, do të thotë vetëm që ju mund të zgjidhni atë që dëshironi në një moment të veçantë.
- Vlera që mer diçka që ke fituar, nuk ka të bëjë vetëm me atë që ju ofron, por dhe me çfarë është sakrifikuar për të arritur atë.
- Respekti nuk imponohet, por fitohet.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	H	2	J	16	J	A		12	7		7	8	6	11					
1	4	3	8				10	1	14		5		1	8					
18	1	8		5	3	9	3	8	2	12	2								
2	8		5	6	4	6	9	1	9	2		8							
8		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3							
6	1	11		12	9	1				8		9	11						
9	3	1		2	6		7	16	2		1	3							
3		7		4		1	8	6		8	2	14							
	13	2	7		7		15	6	3	11		4	6						
4	2	12	2		8		11		1	13	3	17							
1	4	3	7	8	5	20	2	7	6		8	1							
8	1			18	1	9	1	12	1		2	8							

K	U	L	T	M	A	P	L	A	B											
O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R										
R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E									
B			K	L	E	O	P	A	T	R	A									
I	E	K	I	T	R	E	T	E		S										
	L	A	M	E	K	E	R	M	A	T										
T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E										
O	B	R	O	S	C	I	R	M	A											
A	T	E	D	H	I	A	I	R	K											
I	L	E	I	N	E	P	H	I	L											
A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I									
S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O										

Thënie të mençura

- Të gabosh është njerëzore, por të falësh është hyjnore.
- Me kalimin e viteve, disa vetëm rriten dhe disa bëhen të pjekur.
- Nuk më vjen keq për gënjeshtat që më the, por më vjen keq se unë kurrë nuk kam për të të besuar përsëri.
- Një gënjeshtër bëhet më e besueshme kur fshihet në mes të dy të vërtetave.
- Pika më e lartë në një kishë nuk është kryqi por rrufepërësja. Një ironi e fizikës në metafizikë...
- E vërteta shkëlqen akoma edhe kur askush nuk e kërkon.

